SHQIPONJA BIZHGA

# TEATRI 10
# LIBËR PËR MËSUESIN

BOTIME

pegi

# I. HYRJE

***I dashur koleg!***

Teatri është një nga artet më të vjetra në botë, sepse njeriu lind me një nevojë të brendshme për të krijuar art me trupin, zërin e tij, për të krijuar një realitet artistik, ku të shfaqë probleme madhore si një mjet spastrimi ose argëtimi të mirëfilltë.

Teatri ka qenë gjithmonë pjesë e proceseve historike, duke u lidhur ngushtë me politikën, filozofinë, psikologjinë dhe artet e epokave të ndryshme historike. Ndaj, kur ndërthuret me proceset e arsimimit, është një ndihmë e madhe për kulturën e secilit individ dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Njohja me teatrin është një vlerë e madhe për të mundësuar edukimin dhe formimin kulturor, zhvillimin e personalitetit të nxënësve, të aftësive të tyre për të dëgjuar në mënyrë të pavarur e sistematike vepra të ndryshme teatrore si dhe për të menduar dhe gjykuar në mënyrë kritike rreth tyre.

***Pse shërben ky libër?***

Ky libër do t'u shërbejë mësuesve të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale, duke kuptuar më mirë qasjen me bazë kompetencat për zbatimin e saj edhe në kurrikulën e e lëndës Arte/Teatër.

***Çfarë synon ky libër?***

Zbatimi i mësimdhënies bazuar në qasjen me kompetenca do të shërbejë si një udhërrëfyes për të gjithë mësuesit e lëndës së Arteve (Teatrit) të klasës X-XII, të cilët do të ndërtojnë punën e tyre bazuar në njohjen e dokumentacionit të ri: *korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë e arteve, programi mësimor.* Vlerësimi bazuar në *nivelet e arritjes së kompetencave kyçe dhe ato lëndore ,* përkojnë me tri faza mjaft të rëndësishme:

a) planifikimin e të nxënit përmes situatave të të nxënit;

b) metodologjinë e mësimdhënies;

c) vlerësimin e të nxënit bazuar në qasjen e re me kompetenca.

Qëllimi i këtij libri është të orientojë dhe të ndihmojë mësuesit për të përmbushur synimet e kësaj kurrikule, për ndërtimin e *kompetencave lëndore* dhe ato *kyçe*, për të planifikuar dhe për të realizuar detyrat e tyre si mësimdhënës të kësaj lënde, në përputhje me dokumentet zyrtare.

***Çfarë përmban ky libër?***

Ky libër është konceptuar në përputhje me programin e klasës X-XII, për lëndën Arte/Teatër, përkatësisht shkalla e pestë-e gjashtë, miratuar nga MAS në dhjetor 2014.

Ky libër ndihmon mësuesit e lëndës Arte/Teatër:

- *Në* çështje të planifikimit, të metodologjisë dhe të vlerësimit;
- *prezanton* dokumentet e hartuara dhe mënyrën sesi duhet të përdoren ato nga mësuesi;
- *udhëzon* formatet e reja: planifikimi *vjetor, tremujor, ditor, situatat e të nxënit, format e vlerësimit* etj., me të cilat duhet të punojë mësuesi gjatë një viti shkollor.

Ky libër sugjeron, ofron modele, por nuk i dikton ato. Realiteti, niveli i klasës ku mësuesi jep mësim mund të sugjerojë modele të ndryshme për tema të caktuara.

**AUTORJA**

# Përmbajtja

Hyrje 5
Programi mësimor për lëndën arte/teatër dhe kompetencat 6
Planifikimi i kurrikulës 9
Planifikimi vjetor i lëndës teatër sipas tematikave dhe tremujorëve 10
Plani analitik 3–mujor (shtator-dhjetor) 13
Planifikimi 3 – mujor (janar-mars) 23
Plani analitik 3–mujor (prill-qershor) 27
Planifikimi ditor 1 35

## II. PROGRAMI MËSIMOR PËR LËNDËN ARTE/TEATËR DHE KOMPETENCAT

Ky libër ka si qëllim krijimin e kushteve për ndërtimin e ***kompetencave të lëndës*** Arte/Teatër si dhe të ***kompetencave kyçe***, të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën, për realizimin e ***temave ndërkurrikulare*** edhe nëpërmjet lëndës Arte/Teatër, gjë që është gjithashtu një komponent i rëndësishëm i programit të Arte/Teatër. Në këtë libër, gjithashtu, përshkruhet ***lidhja e*** Arte/Teatër ***me fushat e tjera kurrikulare***, në mënyrë që kurrikula e arsimit parauniversitar të funksionojë si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor, atë të formimit të nxënësve.

**1. Kompetencat kyçe dhe lënda Arte/Teatër**

Kompetencat shprehen nëpërmjet përdorimit të njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave kontekstuale në të cilën zhvillohet njohuria teatrore.

Domosdoshmëria e zotërimit të kompetencave i aftëson individët /nxënësit të bëhen të zotë dhe t'i përdorin ato gjatë gjithë jetës.

**Kompetencat kyçe janë:**

1. **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.**
2. **Kompetenca e të menduarit.**
3. **Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.**
4. **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.**
5. **Kompetenca personale.**
6. **Kompetenca qytetare.**
7. **Kompetenca digjitale.**

**Diagrami[1]: Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së teatrit për shkallën V-VI.**

**Rezultatet kryesore të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së teatrit**

| |
|---|
| **1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**<br>**Nxënësi:**<br>**a.** zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë teatrore e në analizimin e tyre;<br>**b.** gjykon në mënyrë kritike dhe të drejtë konceptin teatror e filozofik të veprës;<br>**c.** shprehet qartë dhe komunikon saktë estetikisht dhe artistikisht për vepra të ndryshme teatrore;<br>**ç.** komunikon dhe shprehet nëpërmjet mjeteve shprehëse teatrore në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme, kritike dhe krijuese. |
| **2. Kompetenca e të menduarit**<br>**Nxënësi :**<br>**a.** përpunon njohuritë teatrore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi; |

[1]Ky diagram – tabelë është shkëputur nga programi mësimor i lëndës Arte/Teatër.

| TEMATIKAT E TEATRIT | KOMPETENCAT E TEATRIT |
|---|---|
| ***Tematika 1:*** Gjuha dhe komunikimi teatror | Kompetenca 1: Krijimi teatror |
| ***Tematika 2:*** Teknika dhe procese teatrore | Kompetenca 2: Performimi/interpretimi teatror |
| ***Tematika 3:*** Historia, teatri dhe shoqëria | Kompetenca 3: Vlerësimi i veprave teatrore |

***Kompetenca 1:*** *Krijimi* teatror**,** ka të bëjë me përdorimin e ideve të ndryshme për të organizuar krijimin teatror, përdorimin e elementeve teatrore gjatë krijimit, zhvillimin e ideve të reja gjatë krijimit dhe organizimin e krijimit sipas strukturës teatrore, duke ndarë përvojat e veta krijuese me të tjerët.

***Kompetenca 2: Performimi/interpretimi*** teatror ka të bëjë me kuptimin dhe zbatimin e teknikave teatrore gjatë interpretimit, improvizimit shprehës, respektimin e rregullave të lojës teatrore dhe ndarjen e përvojave të veta performuese me të tjerë.

***Kompetenca 3: Vlerësimi*** teatror ka të bëjë me kuptimin dhe analizimin e veprave teatrore që nga format e vogla e deri tek ato të mëdhatë, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik që i përgjigjet kësaj grupmoshe.

### 3. Kompetencat e veçanta dhe përshkrimi i tyre për lëndën e Arte/Teatër

| Kompetencat e veçanta | Përshkrimi i kompetencave lëndore |
|---|---|
| **Krijimi i veprave teatrore** | **Nxënësi:**<br>**a.** zhvillon mendimin e tij personal mbi elementet teatrore dhe estetike gjatë analizimit të veprës teatrore;<br>**b.** organizon opinionin e vet sipas mjeteve shprehëse të teatrit dhe mendimit estetik;<br>**c.** përdor ide të ndryshme për të organizuar dhe qartësuar mendimin ose mesazhin që përcjell vepra teatrore;<br>**ç.** ndan përvojat e veta teatrore me të tjerët. |
| **Interpretimi i veprave teatrore** | **Nxënësi:**<br>**a.** përjeton emocionalisht gjatë procesit të interpretimit të një vepre, duke dhënë qartë mesazhin që përcjell vepra;<br>**b.** interpreton veprën duke dhënë emocionet e karakterit të veprës sipas *autorit dhe periudhës* në të cilën është realizuar vepra;<br>**c.** bën krahasimin e veprave teatrore, duke përdorur elementet e ndryshme specifike;<br>**ç.** interpreton mendimin e vet mbi përmbajtjet teatrore të pjesëve të parapëlqyera përmes komunikimit artistik dhe estetik të saj;<br>**d.** ndan përvojat e veta interpretuese me të tjerë. |
| **Vlerësimi i veprave** | **Nxënësi:** |

| | |
|---|---|
| **teatrore** | **a.** zhvillon gjykimin dhe mendimin krijues të mendimit teatror dhe estetik;<br>**b.** analizon veprat teatrore që nga antikiteti e deri në ditët tona;<br>**c.** vlerëson veprat teatrore, sipas autorit, veprës dhe periudhës në të cilën është realizuar vepra, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik. |

**4. Kompetencat kyçe dhe lëndore, që formohen përmes tematikave përmbajtësore të teatrit**

**Diagrami[2]: Kompetencat *kyçe dhe lëndore,* që formohen përmes *tematikave përmbajtësore* të teatrit**




*Kompetencat kyçe* dhe *kompetencat lëndore* zhvillohen përmes *tematikave* të lëndës së Arte/Teatër, ku në qendër të mësimdhënies është nxënësi.

**5 . Lidhja e teatrit me fushat e tjera kurrikulare - diagrami[3]**

Teatri është i lidhur me lëndët brenda fushës së saj, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul. Ai lidhet shumë mirë me disiplinat e tjera artistike brenda fushës së arteve si: muzikën, kërcimin, artin pamor, por edhe me fusha të tjera të nxëni brenda kurrikulës si: matematikën, gjuhën dhe komunikimin, shkencat shoqërore dhe mjedisin etj. Kështu mësuesit/et duhet t'u

2. Ky diagram – tabelë është shkëputur nga programi mësimor i lëndës Arte/Teatër.

Ky diagram – tabelë është shkëputur nga programi mësimor i lëndës Arte/tëeatër.

japin mundësinë nxënësve të konsolidojnë dhe formojnë përvojat që ata kanë krijuar, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm këtyre përvojave. Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlëndore të teatrit me lëndë të tjera, të para përmes njohurive.




## III. PLANIFIKIMI I KURRIKULËS

Planifikimi i kurrikulës dhe i përmbajtjes së programit përgjatë tremujorëve është një proces mjaft i rëndësishëm në punën e mësuesit që zgjat gjithë vitin shkollor. Përgatitja e dokumenteve që shoqërojnë punën e tij përgjatë vitit janë të shumta dhe kanë të bëjnë me *planifikimin e kurrikulës* dhe *dokumentet* përkatëse. Planifikimi këtyre dokumenteve të kurrikulës së re nga mësuesi/sja kërkon: liri, fleksibilitet dhe përgjegjshmëri në planifikim. Këto dokumente janë:

1) Planifiki vjetor i lëndës Arte/teatër, sipas 3-mujorëve;
2) Planifikimi 3-mujor (temat janë të ndërthura sipas tematikave);
3) Planifkimi ditor.

Këto tri planifikime, bëhen bazuar në ndarjen e kohës mësimore që sugjeron programi mësimor i teatrit dhënë në tabelën e mëposhtme:

**Tabela: Orë të sugjeruara për çdo tematikë**

| Tematikat | Gjuha dhe komunikimi teatror | Teknikat dhe proceset | Historia teatri dhe shoqëria | Gjithsej orë |
|---|---|---|---|---|
| **Klasa e dhjetë** | **10** | **32** | **30** | **72 orë** |

**PLANIFIKIMI MËSIMOR VJETOR**
**FUSHA: ARTE**
**LËNDA: TEATRI**
**KLASA X-XII**



## 1. PLANIFIKIMI VJETOR I LËNDËS TEATËR SIPAS TEMATIKAVE DHE TREMUJORËVE

| Tematikat | Shtator – Dhjetor<br>24 orë<br>Tematika:<br>1. Gjuha dhe komunikimi teatror (10 orë)<br>2. Teknika dhe procese teatrore (14 orë) | Tematikat | Janar – Mars<br>24 orë<br>Teknika dhe procese teatrore (18 orë)<br>Historia, teatri dhe shoqëria (6 orë) | Prill - Qershor<br>24 orë<br>Tematika:<br>Historia, teatri dhe shoqëria (18 orë) |
|---|---|---|---|---|
| **Gjuha dhe komunikimi teatror** | Prezantimi i lëndës (1) | **Teknika dhe procese teatrore** | Orë praktike. Ushtrime (15) | Teatri i Rilindjes Evropiane (7) |
| | Arti, teatri, mendimi estetik. Kuptimi i përgjithshëm. Teatri dhe mjeti i tij shprehës. Gjuha teatrore. (2) | | Veprimi dramatik, mjeti kryesor i aktorit për realizimin e qëllimit. Etydi dhe komunikimi pa fjalë. (16) | Krijimtaria e Shekspirit (8) |
| | Teatri dhe mjeti i tij shprehës. Gjuha teatrore (3) | | Orë praktike. Ushtrime (17) | Teatri i Klasicizmit Francez dhe i Përtëritjes angleze (9) |
| | Elementet e teatrit (4) | | Marrëdhënia më partnerë (18) | Teatri i Molierit (10) |
| | Simbolizmi dhe konvencioni teatror (5) | | Orë praktike. Ushtrime (19) | Teatri në epokën iluministe (shek. XVIII) (11) |
| | Vepra teatrore dhe | | Përshtatja dhe | Teatri në periudhën romantike (12) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | dramaturgu (6) | | marrëdhënia me partnerë (20) | |
| **Teknika dhe procese teatrore** | Vënia në skenë e një pjese teatrale (projekt; ora 1) | | Orë praktike. Ushtrime (21) | Teatri realist (13) |
| **Gjuha dhe komunikimi teatror** | Zhanret teatrale. Tragjedia (7) | | Veprimi nëpërmjet fjalës, bazë e komunikimit me partnerë (22) | Teatri realist dhe ai modern i shekullit XX (14) |
| | Zhanret teatrale. Komedia dhe tragjikomedia (8) | | Orë praktike. Ushtrime (23) | Simbolizmi, ekspresionizmi, surrealizmi (15) |
| | Interpretimi i elementeve të shfaqjes teatrore. Regjisura, drama e shkruar, loja e aktorit. (9) | | Karakteri. Kuptim i përgjithshëm (24) | B. Brehti dhe ndikimi i tij në teatrin botëror (16) |
| | Interpretimi i elementeve të shfaqjes teatrore. Elementet pamore dhe muzikore. Teatri dhe rrethanat historike e shoqërore. (10) | | Orë praktike. Ushtrime (25) | Teatri Ekzistencialist dhe Teatri i Absurdit (17) |
| **Teknika dhe procese teatrore** | Hyrje (2) | | Procese të krijimit të karakterit. Puna konkrete me rolin. (26) | Rryma, shkolla, stile teatrore bashkëkohore (18) |
| | Faza përgatitore. Procese të analizës dhe të interpretimit të pjesës. (3) | | Orë praktike. Ushtrime (27) | Tendenca në teatrin britanik dhe irlandez (19) |
| | Procese të interpretimit dhe konceptit regjisorial. Stili i | | Projekt: Vënia në skenë e një shfaqje teatrore. | Teatri shqiptar para dhe gjatë Rilindjes Kombëtare. (20) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | shfaqjes. (4) | | (28) | |
| | Procese të interpretimit dhe konceptit regjisorial. Stili i shfaqjes. (5) | | Projekt: Vënia në skenë e një shfaqjeje teatrore. (29) | Fundi i shek XIX-XX. Drama dhe tragjedia (21) |
| | Procese dhe elemente pamore (6) | | Projekt: Vënia në skenë e një shfaqjeje teatrore. (30) | Komeditë e A. Z. Çajupit (22) |
| | Procese dhe elemente pamore (7) | | Projekt: Vënia në skenë e një shfaqjeje teatrore. (31) | Teatri në periudhën e Pavarësisë dhe monarkisë (23) |
| | Procesi i provave (8) | | Projekt: Vënia në skenë e një shfaqjeje teatrore (32) | Komeditë e K. Floqit (24) |
| | Procesi i provave (9) | **Historia, teatri dhe shoqëria** | Lindja e teatrit. Origjina e teatrit antik grek. (1) | Teatri pas vitit 1944 (25) |
| | Aktrimi në jetë dhe në skenë (10). | | Institucioni i teatrit në Greqinë e lashtë. (2) | Themelimi i teatrit profesionist (26) |
| | Procesi i provave (11) | | Përfaqësuesit e teatrit antik greko-romak. Tragjedia. (3) | Zhvillimet deri në vitet ’70-të (27) |
| | Aktrimi si art. Procese dhe parime (12) | | Përfaqësuesit e teatrit antik greko-romak. Komedia (4) | Faza e dytë – mesi i viteve ’80-të (28) |
| | Orë praktike. Ushtrime (13) | | Teatri gjatë Mesjetës (5) | Teatri në dekadat e fundit (29) |
| | Vëmendja skenike. Të parit dhe të dëgjuarit (14) | | Komedia e Artit (6) | Test (30) |
| **72 orë** | 24 **orë** | | 24 **orë** | 24 **orë** |

**FUSHA: ARTE**
**LËNDA: TEATRI**
**KLASA X-XII**

## PLANI ANALITIK 3–MUJOR (SHTATOR-DHJETOR)

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Burimet |
|---|---|---|---|---|
| 1. | **Gjuha dhe komunikimi teatror (10 orë)** | Prezantimi i lëndës | Pyetje, diskutim rreth përvojave teatrore. | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj. |
| 2. | **Gjuha dhe komunikimi teatror** | Arti, teatri, mendimi estetik. Kuptimi i përgjithshëm. Teatri dhe mjeti i tij shprehës. Gjuha teatrore. | CD me foto, video të ndryshme nga natyra, arti, që të krijojnë përjetime artistike të këndshme. | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj.. |
| 3. | **Gjuha dhe komunikimi teatror** | Teatri dhe mjeti i tij shprehës. Gjuha teatrore. | Pyetje, diskutim rreth koncepteve, njohurive të marra më parë: “teatri-art’, “mjeti artistik i teatrit”. | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj. |
| 4. | **Gjuha dhe komunikimi teatror** | Elementet e teatrit | Diskutim rreth përvojave, përjetimeve emocionale të nxënësve, kur kanë vënë në skenë një shfaqje teatrale. | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj. |
| 5. | **Gjuha dhe komunikimi teatror** | Simbolizmi dhe konvencioni teatror | Diskutim rreth përvojave, përjetimeve emocionale të nxënësve, kur kanë vënë në skenë një shfaqje teatrale. | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj.. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 6 | **Gjuha dhe komunikimi teatror** | Vepra teatrore dhe dramaturgu | Diskutim rreth përvojave, përjetimeve emocionale të nxënësve, kur kanë vënë në skenë një shfaqje teatrale. | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj. |
| 7 | **Teknika dhe procese teatrore** | Vënia në skenë e një pjese teatrale (projekt; ora 1) | Diskutim rreth punës hulumtuese për përzgjedhjen e pjesës teatrore që do të vihet në skenë. | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj. |
| 8 | **Gjuha dhe komunikimi** | Zhanret teatrale. Tragjedia | Pyetje rreth llojeve, veçorive, teknikave të shfaqjes teatrore | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj.. |
| 9 | **Gjuha dhe komunikimi teatror** | Zhanret teatrale. Komedia dhe tragjikomedia. | Pyetje rreth llojeve, veçorive, teknikave të komedisë dhe tragjikomedisë. | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj. |
| 10 | **Gjuha dhe komunikimi teatror** | Interpretimi i elementeve të shfaqjes teatrore. Regjisura, drama e shkruar, loja e aktorit. | Pyetje rreth qëllimit, detyrave, rëndësisë së elementeve teatrale. | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj.. |
| 11 | **Gjuha dhe komunikimi teatror** | Interpretimi i elementeve të shfaqjes teatrore. Elementet pamore dhe muzikore. Teatri dhe rrethanat historike e shoqërore. | Pyetje rreth qëllimit, detyrave, rëndësisë së elementeve teatrale (pamore dhe muzikore) dhe rrethanave historiko-shoqërore. | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj. |
| 12 | **Teknika dhe procese** | Hyrje (2) | Pyetje: Ku qëndron çelësi i suksesit të një shfaqjeje teatrore? | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **teatrore**<br><br>**(32 orë)** | | | teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj. |
| 13 | **Teknika dhe procese teatrore** | Faza përgatitore.<br>Procese të analizës dhe të interpretimit të pjesës. (3) | Pyetje:<br>-Pse duhet të analizohet vepra që do të shfaqet në skenë? | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj.. |
| 14 | **Teknika dhe procese teatrore** | Procese të interpretimit dhe konceptit regjisorial. Stili i shfaqjes. (4) | Pyetje: Cili është roli i regjisorit në shfaqjen teatrore? | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj. |
| 15 | **Teknika dhe procese teatrore** | Procese të interpretimit dhe konceptit regjisorial. Stili i shfaqjes. (5) | -Regjisori dhe asistentë regjisorët prezantojnë vizionin, konceptin regjisorial, stilin, platformën regjisoriale të shfaqjes teatrore që nxënësit do të vënë në skenë. | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj.. |
| 16 | **Teknika dhe procese teatrore** | Procese dhe elemente pamore (6) | Pyetje: Cilat janë detyrat e skenografit/ kostumografit? Pse është i rëndësishëm roli i skenografit/ kostumografit në shfaqjen teatrore? | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj. |
| 17 | **Teknika dhe procese teatrore** | Procese dhe elemente pamore (7) | Nxënësit prezantojnë maketet e skenografisë, si dhe skicat e kostumeve të shfaqjes së tyre. | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj. |
| 18 | **Teknika dhe** | Procesi i provave (8) | Pyetje: Si do t'i organizojmë provat e | Teksti i Arteve; klasa X-XII, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **procese teatrore** | | shfaqjes? | Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj.. |
| 19 | **Teknika dhe procese teatrore** | Procesi i provave (9) | Pyetje: A jeni të qartë mbi interpretimin artistik, mbi lëvizjet, tiparet e karaktereve të personazheve të shfaqjes suaj teatrore? | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj. |
| 20 | **Teknika dhe procese teatrore** | Aktrimi në jetë dhe në skenë (10). | Nxënësit prezantojnë nëpërmjet CD detyrën e shtëpisë: imitime,etyde, interpretime aktorësh të spektakleve televizive. | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj.. |
| 21 | **Teknika dhe procese teatrore** | Procesi i provave (11) | Nxënësit interpretojnë artistikisht atë ç'kanë përgatitur si detyrë shtëpie. | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj. |
| 22 | **Teknika dhe procese teatrore** | Aktrimi si art. Procese dhe parime (12) | Pyetje:<br>-Për se doni të bëheni aktor?<br>-Ç'dini për përvoja artistësh të mëdhenj? Si e kanë arritur ata suksesin? | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj. |
| 23 | **Teknika dhe procese teatrore** | Orë praktike. Ushtrime (13) | Nxënësit interpretojnë artistikisht atë ç'kanë përgatitur si detyrë shtëpie. | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj.. |
| 24 | **Teknika dhe procese teatrore** | Vëmendja skenike. Të parit dhe të dëgjuarit (14) | Pyetje: Cilat janë elementet e domosdoshme që krijojnë kujtesën emocionale? | Teksti i Arteve; klasa X-XII, Interneti, enciklopedi, literaturë nga arti, teatri dhe nga fusha të tjera, modele të detyrave të nxënësve etj. |

## 2. REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE SIPAS TEMATIKAVE

### 2.1. Tematika: Gjuha dhe komunikimi teatror

**A. PËRSHKRIMI I TEMATIKËS**

Teatri dhe shumë çështje të tij trajtohen përmes studimit të zhvillimit të mendimit teatror, estetik, si dhe gjuhës teatrore. Të gjitha këto trajtohen nëpërmjet studimit të artit në përgjithësi dhe tipareve të përbashkëta të arteve midis tyre, çfarë përfaqëson teatri dhe cilat janë mjetet shprehëse, elementet teatrore me të cilat krijohet, interpretohet dhe studiohet teatri. Janë format dhe gjinitë teatrore, epokat historike dhe stili i autorëve, të cilat, nëse arrijmë t'i mësojmë dhe shpjegojmë, arrijmë të kuptojmë të bukurën në teatër, të komunikojmë përmes një gjuhe teatrore korrekte, gjë që kërkon një njohje të elementeve dhe parimeve të formësimit të teatrit për ta kuptuar, analizuar, vlerësuar, interpretuar dhe gjykuar mbi një vepër të caktuar teatrore.

Të mos harrojmë që nxënësi ka pasur kontakte më të hershme me teatrin në shkallë më të ulëta arsimore, pra tani kemi të bëjmë me thellim të njohurive mbi elementet teatrore e kombinimin e tyre në skenë, që do të çojnë në edukimin e nxënësve me interpretimin, paraqitjen skenike, të folurin publik dhe të qenit bindës në rolin e tyre para publikut. Nxënësit, përveç se zhvillojnë ndjenjën e përdorimit të imagjinatës e aftësive vetjake përmes përjetimeve konkrete interpretuese, zhvillojnë edhe aftësinë për ta paraqitur lojën skenike. Procese të tilla si: zbulimi, përjetimi, dëgjimi, analizimi, interpretimi apo çfarëdo krijimi i lidhur me gjuhën teatrore ndihmon nxënësit të zhvillojnë jo vetëm kompetencën e krijimit, por edhe të zbatimit konkret të gjuhës teatrore në pjesë teatrale e analizimin kompetent të një vepre teatrore. Pavarësisht se cila do të jetë pjesa që do të vendoset të interpretohet (që do të jetë një pjesë shqiptare e vendosur mbi bazë argumenti "pro" e "kundër" pas diskutimeve të ndryshme midis mësuesit e nxënësve, që do të jenë pjesë e saj), në këto orë nxënësit do të njihen edhe një herë, tashmë në mënyrë të përmbledhur me mbarë historinë e teatrit botëror e shqiptar dhe për të vënë në skenë, do të marrin parasysh pjesë të dramaturgjisë botërore apo shqiptare të sugjeruara nga mësuesi ose të hulumtuara nga ata vetë, çka do të ndihmojë që të zhvillohen biseda të rrjedhshme mes mësuesit e nxënësve mbi këto pjesë, duke e ndihmuar arsimtarin të shpalosë veçoritë e gjinisë, të stilit, të tematikës, të epokës historike e rrethanave shoqërore, kombëtare etj., që do të sjellë jo vetëm përgatitjen e terrenit për teknikat teatrore që do të vijojnë, por do të thellojë edhe njohuri të bazuara të nxënësit mbi të gjitha këto tipare të dramaturgjisë shqipe në veçanti dhe parimet e saj universale, në përgjithësi.

**B. REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS**

**Krijimi teatror:**

**a.** njeh me saktësi kuptimin e formave dhe gjinive teatrore;
**b.** komunikon mendimin e vet për vepra të ndryshme teatrore, duke përdorur një gjuhë të saktë;
**c.** zhvillon idenë rreth të bukurës në teatër përmes mendimit estetik;
**ç.** ndan përvojat e veta teatrore me të tjerët.

**Interpretimi teatror:**

**a.** interpreton idenë e vet përmes një gjuhe të saktë, për një vepër të caktuar teatrore;
**b.** njeh ndikimin dhe pasqyrimin e historisë në teatër e anasjelltas, duke dhënë shembuj konkretë;
**c.** përjeton vepra të ndryshme teatrore nga ana emocionale dhe interpreton përjetimin e vet emocional përmes esesë, vizatimit ose fjalës;
**ç.** interpreton ndryshimin e gjendjeve emocionale gjatë ndjekjes së veprave të ndryshme teatrore;
**d.** shpjegon qartë kuptimin e formës teatrore, gjinisë dhe stilit teatror.

**Vlerësimi teatror:**

**a.** evidenton praninë e teatrit në jetën e përditshme dhe e vlerëson atë;
**b.** formulon ide të ndryshme rreth artit dhe teatrit duke shprehur mendimin e vet rreth përjetimit emocional;
**c.** vlerëson përmes përjetimit një vepër teatrore, të gjinisë dhe stilit teatror.

### 3. 2. Tematika: Teknika dhe procese teatrore

### A. PËRSHKRIMI I TEMATIKËS

Interpretimi i një pjese kërkon së pari interes në arsyen pse përzgjidhet ajo. Në fazën e parë, mësuesit e nxënësit kanë argumentuar mbi rrethanat historike e shoqërore të pjesës që kanë përzgjedhur, mbi gjininë e saj, llojin e dramaturgjisë që përfaqëson, etj. Në këtë fazë, teksa fillojnë ta vënë në skenë, ata hulumtojnë më tej me konceptin regjisorial që kanë zgjedhur dhe në bazë të tij fillojnë të ndërtojnë etydet, të krijojnë siluetat e personazheve, marrëdhëniet në skenë mes tyre, nëntekstet e atyre çka thonë, ashtu siç fillojnë të mendojnë për stilin e kostumeve, skenografisë, rekuizitave, ndriçimit e muzikës, që të gjitha në varësi të zhanrit të dramaturgjisë. Ose, nëse nuk i kanë qëndruar besnik pjesës, por kanë krijuar një koncept regjisorial krejt të pavarur, të përkojnë me këtë të fundit. Duhet mbajtur parasysh se ka nxënës, që më shumë se të prirur për të interpretuar, e duan teatrin prej vizioneve regjisoriale që kanë apo

thjesht nuk janë të aftë të interpretojnë, por të realizojnë elemente të tjera të shfaqjes (kostumet, muzikën, skenografinë). Duhet bërë kujdes që këta nxënës, pavarësisht se nuk luajnë rol skenik, të nxiten të zhvillojnë vizionin e tyre artistik në këtë aspekt që është gjithaq i rëndësishëm sa edhe interpretimi skenik. Të mos harrojmë edhe një herë që nxënësi vjen me dije më të hershme e më të përcipta të teatrit, nga shkallë të hershme, ndaj tani prej tij pritet punë e pavarur në thellimin e disa koncepteve, në mënyrë që diskutimi me mësuesin të jetë e një niveli bashkëbisedimi e jo thjesht direktiva nga mësuesi. Kjo do të sjellë jo vetëm zhdërvjelltësi të mendimit të nxënësit e siguri të tij, por edhe një përjetim më të mirë, si një punë e mundimshme, por e shpërblyer në përfundim të shfaqjes. Kënaqësitë dhe vështirësitë e këtyre projekteve u mësojnë nxënësve vlerat e ndërmarrjes së një projekti dhe përfundimi i tij me vullnet të lirë, drejt një fundi të suksesshëm: një aftësi mjaft e nevojshme kjo në të ardhmen e tyre.

## B. REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT E LËNDËS

### Krijimi teatror

Nxënësi:

**a.** bën rolin e regjisorit/skenografit/kostumografit në një pjesë të plotë teatrore;
***b.*** *interpreton saktë detyrën sipas* zhanrit, epokës, konceptit regjisorial;
**c.** bën krahasimin e pjesëve teatrore që interpreton, duke përdorur elementet dhe parimet e formësimit teatror.

### Interpretimi teatror

Nxënësi:

**a.** interpreton idetë e veta, duke komunikuar artistikisht dhe estetikisht mbi një vepër teatrore;
**b.** sjell një kuptim të qartë të pjesës teatrore sipas autorit, veprës dhe periudhës në të cilën është realizuar vepra;
**c.** ndan përvojat e veta interpretuese me të tjerë.

### Vlerësimi i veprave teatrore

Nxënësi:

**a.** vlerëson interpretimin e veprave të ndryshme teatrore;
**b.** përjeton dhe vlerëson interpretimin artistik, duke zhvilluar gjykimin mbi këto vepra;
**c.** reflekton emocionet që i krijon një vepër skenike gjatë kohës që interpretohet.

## 1.3 Rezultatet kryesore të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së teatrit

| |
|---|
| **1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit**<br>**Nxënësi:**<br>**a.** zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë teatrore e në analizimin e tyre;<br>**b.** gjykon në mënyrë kritike dhe të drejtë konceptin teatror e filozofik të veprës;<br>**c.** shprehet qartë dhe komunikon saktë estetikisht dhe artistikisht për vepra të ndryshme teatrore;<br>**ç.** komunikon dhe shprehet nëpërmjet mjeteve shprehëse teatrore në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme, kritike dhe krijuese. |
| **2. Kompetenca e të menduarit**<br>**Nxënësi :**<br>**a.** përpunon njohuritë teatrore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;<br>**b.** zgjidh probleme të ndryshme që lidhen me teatrin apo artin, në jetën e përditshme apo në klasë/shkollë;<br>**c.** zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese gjatë ndjekjes së një vepre teatrore;<br>**ç.** ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim, projekt apo veprimtari teatrore artistike. |
| **3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë**<br>**Nxënësi:**<br>**a**. vendos njohuritë teatrore në funksion të realizimit të një argumenti, krijimi apo projekti skenik/artistik;<br>**b.** përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një punë të vetën mbi artin në përgjithësi apo teatrin në veçanti;<br>**c.** zhvillon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë, duke shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni. |
| **4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**<br>**Nxënësi :**<br>**a.** zhvillon aftësitë menaxhuese artistike lidhur me një projekt skenik;<br>**b.** drejton aktivitetet teatrore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese. |
| **5. Kompetencat personale**<br>**Nxënësi :**<br>**a.** krijon besimin tek vetja, në rolin që ndërmerr gjatë veprimtarive teatrore/artistike; merr pjesë dhe kontribuon në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet;<br>**b.** zhvillon vetëbesimin tek aftësitë e veta dhe krijon lirshmëri dhe besim tek të tjerët në realizimin e detyrave artistike. |
| **6. Kompetenca qytetare** |

| |
|---|
| **Nxënësi :**<br>**a.** promovon me qytetari, vlerat të ndryshme kulturore dhe teatrore të vendit apo të krahinës; respekton punën dhe mendimin e të tjerëve lidhur me çështje artistike /teatrore;<br>**b.** bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët. |
| **7. Kompetenca digjitale**<br>**Nxënësi :**<br>**a.** shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet lidhur aspekte të ndryshme kulturore/teatrore; përdor /njeh mjete të ndryshme në funksion të informacionit teatror si: magnetofon, audio, video, CD, DVD etj. |

**4. Kompetencat e veçanta dhe përshkrimi i tyre**

| **Kompetencat e veçanta** | **Përshkrimi i kompetencave** |
|---|---|
| **Krijimi i veprave teatrore** | **Nxënësi:**<br>**a.** zhvillon mendimin personal mbi elementet teatrore dhe estetike gjatë analizimit të veprës teatrore;<br>**b.** organizon opinionin e vet sipas mjeteve shprehëse të teatrit dhe mendimit estetik;<br>**c.** përdor ide të ndryshme për të organizuar dhe qartësuar mendimin ose mesazhin që përcjell vepra teatrore;<br>**ç.** ndan përvojat e veta teatrore me të tjerë. |
| **Interpretimi i veprave teatrore** | **Nxënësi:**<br>**a.** përjeton emocionalisht gjatë procesit të interpretimit të një vepre, duke dhënë qartë mesazhin që përcjell vepra;<br>**b.** interpreton veprën duke dhënë emocionet e karakterit të veprës sipas *autorit dhe periudhës* në të cilën është realizuar vepra;<br>**c.** bën krahasimin e veprave teatrore, duke përdorur elementet e ndryshme specifike;<br>**ç.** interpreton mendimin e vet mbi përmbajtjet teatrore të pjesëve të parapëlqyera përmes komunikimit artistik dhe estetik të saj;<br>**d.** ndan përvojat e veta interpretuese me të tjerë. |
| **Vlerësimi i veprave teatrore** | **Nxënësi:**<br>**a.** zhvillon gjykimin dhe mendimin krijues të mendimit teatror dhe estetik; |

<table>
<tr><td></td><td>b. analizon veprat teatrore që nga antikiteti e deri në ditët tona;<br>c. vlerëson veprat teatrore, sipas autorit, veprës dhe periudhës në të cilën është realizuar vepra, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.</td></tr>
<tr><td colspan="2">5. Metodologjia, veprimtaritë e nxënësve<br>• Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse<br>• Puna në grup dhe puna individuale<br>• Hetimi dhe zbulimi<br>• Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase<br>• Metoda integruese<br>• Bashkëbisedim<br>• Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues<br>• Prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK<br>• Projekte kurrikulare</td></tr>
<tr><td colspan="2">6. Vlerësimi<br>Vlerësim diagnostikues<br>Përgatitjet serioze, bashkëpunuese për projektin.<br>Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)<br>• vlerësimi i përgjigjeve me gojë<br>• vlerësimi i punës në grup<br>• vlerësim mes nxënësish<br>• vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë<br>• vlerësimi i detyrave të shtëpisë<br>• vetvlerësim<br>• intervistë me një listë treguesish<br>• vëzhgim me një listë të plotë treguesish<br>• portofol<br>• prezantim me gojë ose me shkrim<br>• projekt kurrikular</td></tr>
</table>

**FUSHA: ARTE**
**LËNDA: TEATRI**
**KLASA X-XII**

**PLANIFIKIMI 3 – MUJOR (JANAR-MARS)**

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Burimet |
|---|---|---|---|---|
| 25 | **Teknika procese teatrore** | Orë praktike. Ushtrime (15) | Nxënësit interpretojnë artistikisht atë ç'kanë përgatitur si detyrë shtëpie. | Teksti i Arteve; klasa, X-XII; materiale nga interneti; materiale nga enciklopedi; tekst nga fusha të tjera; slajde/ në ppt, materiale të krijuara nga mësuesit; modele të detyrave nga nxënësit |
| 26 | **Teknika procese teatrore** | Veprimi dramatik, mjeti kryesor i aktorit për realizimin e qëllimit. Etydi dhe komunikimi pa fjalë (16) | Pyetje: Si e kuptoni shprehjen "Veprimi dramatik, mjeti kryesor i aktorit për realizimin e qëllimit"? | |
| 27 | **Teknika procese teatrore** | Orë praktike. Ushtrime (17) | Nxënësit interpretojnë artistikisht atë ç'kanë përgatitur si detyrë shtëpie. | |
| 28 | **Teknika procese teatrore** | Marrëdhënia më partnerë (18) | Pyetje: Ç'do të thotë të ndërtosh marrëdhënie me partnerë skenikë? | |
| 29 | **Teknika procese teatrore** | Orë praktike. Ushtrime (19) | Nxënësit interpretojnë artistikisht atë ç'kanë përgatitur si detyrë shtëpie. | |
| 30 | **Teknika procese teatrore** | Përshtatja dhe marrëdhënia me partnerë (20) | Pyetje: Në analogji me jetën, pse dhe si përshtatet aktori në skenë? | |
| 31 | **Teknika procese** | Orë praktike. Ushtrime (21) | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **teatrore** | | | |
| 32 | **Teknika procese teatrore** | Veprimi nëpërmjet fjalës, bazë e komunikimit me partnerë (22) | | |
| 33 | **Teknika procese teatrore** | Orë praktike. Ushtrime (23) | | |
| 34 | **Teknika procese teatrore** | Karakteri. Kuptim i përgjithshëm (24) | | |
| 35 | **Teknika procese teatrore** | Orë praktike. Ushtrime (25) | | |
| 36 | **Teknika procese teatrore** | Procese të krijimit të karakterit. Puna konkrete me rolin (26) | | |
| 37 | **Teknika procese teatrore** | Orë praktike. Ushtrime (27) | | |
| 38 | **Teknika procese teatrore** | Projekt: Vënia në skenë e një shfaqje teatrore (28) | | |
| 39 | **Teknika procese teatrore** | Projekt: Vënia në skenë e një shfaqjeje teatrore (29) | | |
| 40 | **Teknika procese teatrore** | Projekt: Vënia në skenë e një shfaqjeje teatrore (30) | | |
| 41 | **Teknika procese** | Projekt: Vënia në skenë | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **teatrore** | e një shfaqjeje teatrore (31) | | |
| 42 | **Teknika procese teatrore** | Projekt: Vënia në skenë e një shfaqjeje teatrore (32) | | |
| 43 | **Historia, teatri dhe shoqëria (30 orë)**<br>**Historia e teatrit botëror** | Lindja e teatrit. Origjina e teattrit antik grek. (1) | | |
| 44 | | Institucioni i teatrit në Greqinë e lashtë. (2) | | |
| 45 | | Përfaqësuesit e teatrit antik greko-romak. Tragjedia. (3) | | |
| 46 | | Përfaqësuesit e teatrit antik greko-romak. Komedia. (4) | | |
| 47 | | Teatri gjatë Mesjetës. (5) | | |
| 48 | | Komedia e Artit (6) | | |
| | **Metodologjia veprimtaritë e nxënësve**<br>• Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse<br>• Puna në grup dhe puna individuale<br>• Hetimi dhe zbulimi<br>• Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase<br>• Metoda integruese<br>• Bashkëbisedim<br>• Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues<br>• Prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK<br>Projekte kurrikulare | | | |

**Vlerësimi**

***Vlerësim diagnostikues***

Përgatitjet serioze, bashkëpunuese për projektin.

***Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)***

- vlerësimi i përgjigjeve me gojë
- vlerësimi i punës në grup
- vlerësim mes nxënësish
- vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë
- vlerësimi i detyrave të shtëpisë
- vet vlerësim
- intervistë me një listë treguesish
- vëzhgim me një listë të plotë treguesish
- portofol
- prezantim me gojë ose me shkrim

projekt kurrikular

**FUSHA: ARTE**
**LËNDA: TEATRI**
**KLASA X-XII**

**PLANI ANALITIK 3–MUJOR (PRILL-QERSHOR)**

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Burimet |
|---|---|---|---|---|
| 49 | **Historia, teatri dhe shoqëria**<br><br>**Historia e teatrit botëror** | Teatri i Rilindjes Evropiane (7) | | Teksti i Arteve; klasa, X-XII<br>Materiale nga interneti<br>Materiale nga enciklopedi<br>Tekst nga fusha të tjera<br>Slide/ në ppt, materiale të krijuara nga mësuesit<br>Modele të detyrave nga nxënësit |
| 50 | **Historia e teatrit botëror** | Krijimtaria e Shekspirit (8) | | |
| 51 | **Historia e teatrit botëror** | Teatri i Klasicizmit Francez dhe i Përtëritjes angleze (9) | | |
| 52 | **Historia e teatrit botëror** | Teatri i Molierit (10) | | |
| 53 | **Historia e teatrit botëror** | Teatri në epokën iluministe (shek. XVIII) (11) | | |
| 54 | **Historia e teatrit botëror** | Teatri në periudhën romantike (12) | | |
| 55 | **Historia e teatrit botëror** | Teatri realist (13) | | |
| 56 | **Historia e teatrit botëror** | Teatri realist dhe ai modern i shekullit XX | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | (14) | | |
| 57 | **Historia e teatrit botëror** | Simbolizmi, ekspresionizmi, surrealizmi (15) | | |
| 58 | **Historia e teatrit botëror** | B. Breht dhe ndikimi i tij në teatrin botëror (16) | | |
| 59 | **Historia e teatrit botëror** | Teatri Egzistencialis dhe Teatrii Absurdit (17) | | |
| 60 | **Historia e teatrit botëror** | Rryma, shkolla, stile teatrore bashkëkohore (18) | | |
| 61 | **Historia e teatrit botëror** | Tendenca në teatrin britanik dhe irlandez (19) | | |
| 62 | **Historia e teatrit shqiptar** | Teatri shqiptar para dhe gjatë Rilindjes Kombëtare (20) | | |
| 63 | **Historia e teatrit shqiptar** | Fundi i shek XIX-XX. Drama dhe tragjedia (21) | | |
| 64 | **Historia e teatrit shqiptar** | Komeditë e A. Z. Çajupit (22) | | |
| 65 | **Historia e teatrit shqiptar** | Teatri në periudhën e Pavarësisë dhe monarkisë (23) | | |
| 66 | **Historia e teatrit shqiptar** | Komeditë e K. Floqit (24) | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 67 | **Historia e teatrit shqiptar** | Teatri pas vitit 1944 (25) | | |
| 68 | **Historia e teatrit shqiptar** | Themelimi i teatrit profesionist (26) | | |
| 69 | **Historia e teatrit shqiptar** | Zhvillimet deri në vitet 70 (27) | | |
| 70 | **Historia e teatrit shqiptar** | Faza e dytë –mesi i viteve 80 (28) | | |
| 71 | **Historia e teatrit shqiptar** | Teatri në dekadat e fundit (29) | | |
| 72 | **Historia e teatrit shqiptar** | Test (30) | | |

**Metodologjia veprimtaritë e nxënësve**

- Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse
- Puna në grup dhe puna individuale
- Hetimi dhe zbulimi
- Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase
- Metoda integruese
- Bashkëbisedim
- Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues
- Prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK

Projekte kurrikulare

**Vlerësimi**

***Vlerësim diagnostikues përmbledhës***

Test

***Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues)***

- vlerësimi i përgjigjeve me gojë
- vlerësimi i punës në grup

| | |
|---|---|
| | • vlerësim mes nxënësish<br>• vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë<br>• vlerësimi i detyrave të shtëpisë<br>• vetëvlerësim<br>• intervistë me një listë treguesish<br>• vëzhgim me një listë të plotë treguesish<br>• portofol<br>• prezantim me gojë ose me shkrim projekt kurrikular |

**QËNDRIME DHE VLERA**

**Nxënësi:**

**a.** dëgjon dhe shpreh mendimin e vet të bazuar në njohuritë teatrore mbi format, gjinitë dhe stilet teatrore;
**b.** shpjegon emocionin e krijuar nga veprat teatrore përmes përjetimit të tyre konkret;
**c.** shpreh idetë e veta për teatrin që dëgjon;
**ç.** komunikon dhe shprehet artistikisht për një pjesë teatrore;
**d.** demonstron vetëbesim në aktivitete të ndryshme teatrore/skenike;
**dh.** komunikon në mënyrë të pavarur, duke argumentuar qartë mendimin e vet;
**e.** merr pjesë aktive në veprimtaritë teatrore vetëm dhe në grup;
**ë.** përdor imagjinatën për të krijuar ose interpretuar mendimin mbi teatrin dhe veprat teatrore;
**f.** krijon vetëbesim gjatë prezantimit të punëve të veta;
**g.** bashkëpunon vetëm dhe me të tjerë në një veprimtari teatrore/projekt të përbashkët;
**gj.** respekton diversitetin ndaj qëndrimeve e koncepteve të ndryshme teatrore që dëgjon, përjeton apo njeh;
**h.** respekton krijimet e veta dhe të tjerëve;
**i.** zhvillon një gjykim të saktë ndaj veprave të ndryshme teatrore që dëgjon, pavarësisht karakteristikave *historike, politike, kulturore, fetare* që ndikuan në zhvillimin e kulturës teatrore në periudha të ndryshme;
**j.** interpreton duke treguar njohje shumë të mirë të kulturës kombëtare apo të kulturave të tjera;
**f.** zhvillon frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë proceseve të ndryshme artistike;
**g.** përqendrohet dhe tregon durim gjatë punëve krijuese dhe interpretuese.

**V. Udhëzime metodologjike**

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënit të teatrit është kusht për rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin artistik që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të teatrit do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, të përjetojnë dhe provojnë vetë dukuritë dhe fenomenet teatrore. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet një motivimi të drejtë dhe përkundrejt zhvillimit të një kompetence të caktuar, e cila arrihet nëpërmjet rezultateve të të nxënit dhe tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e teatrit, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari emocionale dhe fizike jo gjithmonë krejtësisht të vetëdijshme për nxënësit e kësaj grupmoshe. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore teatrore është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit drejtohen drejt një veprimtarie në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit intelektual/artistik në shumë

aspekte.

Mësimdhënia e teatrit synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca, mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien e nxënien e integruar.

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në mësimin e teatrit mban parasysh:

– kompetencat kryesore të të nxënit në teatër;
– lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie të mbështeten në ato të mëparshmet;
– formimin dhe forcimin e aftësive bazë skenike;
– rëndësinë e zbatimeve praktike skenike, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet e komunikimit e të kuptuarit në situata të jetës reale;
– rëndësinë e përdorimit të mjeteve teatrore konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
– veçoritë e interpretimit në mënyrë individuale dhe në grup;
– nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
– rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së teatrit dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj;
– nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit.

Një mësimdhënie e menduar dhe e planifikuar siç duhet krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat teatrore janë të përcaktuara në këtë program, janë të ndërlidhura dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënit që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Ata janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, krijime ose simulime të njohurive, interpretime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në teatër.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësi të punojë me situata ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si: “Pse më pëlqen?”, “A është vënë në skenë siç duhet?”, “A është interpretuar mirë?” etj. Në këtë mënyrë, ai nxitet të reflektojë mbi veprimet e tij dhe të ndërmarrë situata të reja. Projektet kurrikulare afatgjata lejojnë nxënësin të aplikojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron nga njëra anë dhe nga ana tjetër arrin të krijojë lidhje integruese me lëndë të tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj. Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre, janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave skenike/artistike, por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.

## VI. Udhëzime për vlerësimin

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënit bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e kompetencave, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësin me informacionin përkatës për përparimin e tij. Sigurisht është i domosdoshëm edhe vlerësimi i përmbajtjes lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive skenike nëpërmjet treguesve të besueshëm për përparimin e tyre (p.sh. vetëvlerësimi, interpretim i një sërë materialesh, portofol me punë artistike, prezantim me gojë, pjesëmarrja në një projekt kurrikular etj.) Vlerësimi përshkon gjithë procesin mësimor dhe i shërben përmirësimit të këtij procesi. Në teatër, ndryshe nga lëndët e tjera, mbështetet në parimin e individualizimit, ku çdo nxënës posedon dhe zhvillon prirje të veçanta, duke u shprehur në mënyrë individuale, por të bashkërenduara në një punë finale grupi. Inkurajimi, imagjinata, shprehja origjinale dhe krijuese, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi i punëve artistike janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në arte. Gjithashtu, pjesëmarrja individuale dhe në grup, në aktivitete të ndryshme artistike që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënit dhe objekt i vlerësimit janë krijimi i kompetencave teatrore të nxënësve, përmes krijimit, interpretimit dhe vlerësimit. Arritjet në fushën e teatrit dhe të arteve janë si individuale ashtu edhe në kontributin e tyre të punës në ansambël, prandaj duhet edhe të vlerësohen në të dyja aspektet.

Kjo gjë bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara, që arrin të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike, d.m.th., përmes të interpretuarit, të krijuarit, të analizuarit të pjesëve artistike etj. Nxënësit vlerësohen, ndërsa demonstrojnë arritjet nëpërmjet veprimtarive e produkteve të ndryshme.

Dosja e nxënësit është një tjetër mundësi vlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor në teatër. Ajo mund të përmbajë krijime dhe projekte kurrikulare, prodhime të ndryshme në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj. Vlerësimi i nxënësve bëhet sipas kompetencave përkatëse që ata duhet të zhvillojnë.

## VII. Materiale dhe burime mësimore

Gjatë mësimit të teatrit, për realizimin e kompetencave, mësuesi përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Mësuesi përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon ambiente për aktivitete alternative etj. Edhe teknologjia ka një ndikim të madh në këtë fushë duke ndihmuar nxënësit të eksplorojnë shfaqje, muzikë, metoda si të bëjnë diçka, elemente artistike, informacione për teatrin, materiale letrare, duke zhvilluar aftësitë e tyre në studimin e teatrit. Mësuesi përdor fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore dhe me një fjalor të pastër, por të

thjeshtë të gjuhës teatrore. Mësuesi siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Ai u prezanton/sqaron nxënësve përmbajtje të caktuara ose shkathtësi që ata duhet të interpretojnë.

Mësuesi u krijon mundësi nxënësve të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të mediave detyra dhe projekte të ndryshme.

Teatri studiohet përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve, si: shikim të shfaqjeve, kërkimi për elemente të nevojshme, që kërkon shfrytëzimin e mediave të ndryshme, TV, pajisje digjitale si kompjuterët, etj. Përveç materialeve shfrytëzohen edhe burime mësimore si teksti shkollor, interneti etj. Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

Mjetet natyrore si: vetë trupi i njeriut, zëri etj.

Mjetet audio-vizuale si: TV, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.

Mjetet verbale, tekstet si: tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, katalogë, libra jashtëshkollorë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe demonstruar vepra të ndryshme teatrore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për teatrin. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre krijuese dhe interpretuese, si dhe në kryerjen e krijimeve të ndryshme.

Mjedisi mësimor si: klasa, studio pune, ambient interpretimi etj.

**Data_________________**

**PLANIFIKIMI DITOR 1**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
| **TEMATIKA 1: GJUHA DHE KOMUNIKIMI TEATROR**<br><br>**Tema mësimore (1): Prezantim i lëndës** | | **Situata e të nxënit:**<br>Pyetje, diskutim rreth përvojave teatrore. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- shpreh qartë artistikisht mendime, ndjenja, ide rreth teatrit dhe përvojave teatrore;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;<br>-vlerëson estetikisht shfaqjen teatrale përmes përjetimit dhe përvojave personale. | | **Fjalët kyçe:**<br>-teatër, drama, aktor, spektator, ndjenjë, emocion, mbresa, shoqëri etj. | |
| **Burimet:** Teksti *Arte/ teatri* | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>• letërsi, qytetari, histori. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**<br>**Metoda dhe teknika: Diskutim, Punë e pavarur.** | | | |

**ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**

**I. *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

A. Prezantimi midis nxënësve dhe mësueses/it

B. Prezantohet tema e mësimit nga mësuesi/ja: "**Prezantim i lëndës, njohurive, detyrave, të cilat do të zhvillohet gjatë vitit shkollor**"

b. Diskutim

Drejtohen nga mësuesi/ja pyetjet:

- Cilat kanë qenë përvojat, mbresat që ju ka lënë lënda e arteve në shkollën 9-vjeçare?
- Ju pëlqen teatri? Pse? Sa herë shkoni në teatër? Më shumë frekuentoni teatrin apo kinemanë? Pse?
- A keni realizuar detyra, projekte që lidhen me dramatizimin, vënien në skenë të një fragmenti ose një pjese teatrore? Ç'mbresa ruani?
- Ç'vend zë në jetën shoqërore teatri dhe ç'vlera ka ai?

Nxënësit shprehen dhe diskutojnë lirshëm rreth pyetjeve të mësipërme. Dëgjojnë me vëmendje dhe respektojnë mendimet e të tjerëve.

**II. *Ndërtimi i njohurive të reja***

Mësuesi/ja i njeh nxënësit shkurtimisht me:

| |
|---|
| - lëndën, programin (qëllimin, objektin e studimit, tematikat, strukturën, kompetencat lëndore etj.)<br>- detyrat përmbledhëse, vlerësimet, mjetet mësimore etj.<br>- projektin e vënies në skenë të një pjese teatrale që do të zgjidhet dhe do të përgatitet prej tyre, si kurrëzim i njohuritë e marra në këtë lëndë. Orientohen nxënësit se ku duhet t"i kërkojnë pjesët teatrore, autorët që mund të zgjedhin etj. |
| **III. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve në:**<br>- shpreh qartë artistikisht mendime, ndjenja, ide rreth teatrit dhe përvojave teatrore;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;<br>- vlerëson estetikisht shfaqjen teatrale përmes përjetimit dhe përvojave personale;<br>- vlerësimin estetik të një shfaqje teatrore përmes përjetimit dhe përvojave personale. |
| **IV. Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>*- Kërkohet nga nxënësit të hulumtojnë, të zgjedhin dhe të shohin një shfaqje teatrale në Internet, të pëlqyer për ta , për të cilën do të diskutohet në orët e ardhshme, me qëllimin final vënien në skenë të saj nga nxënësit, si detyrë përmbledhëse, vlerësuese për ta .*<br>*- Nxënësit do të sjellin foto nga natyra, artet, për të cilat ata i vlerësojnë të bukura.* |

**Data_________________**

**PLANIFIKIMI DITOR 2**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 1: GJUHA DHE KOMUNIKIMI TEATROR**<br><br>**Tema mësimore (2): Arti, teatri dhe mendimi estetik. Kuptimi i përgjithshëm** | | **Situata e të nxënit:**<br>CD me foto, video të ndryshme nga natyra, arti, që të krijojnë përjetime artistike të këndshme. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- shpjegon saktë kuptimet e termave dhe shprehjeve: "art", "estetikë", "e bukura në teatër", "katarsis";<br>- ndan përvojat e veta estetike me të tjerët;<br>- përshkruan qartë tiparet e përbashkëta të arteve;<br>- interpreton, përmes një gjuhe të saktë, përjetimet e veta emocionale të së bukurës në natyrë dhe art;<br>- vlerëson të bukurën përmes përjetimit të një vepre | | **Fjalët kyçe:**<br>-art, teatër, estetikë, e bukura, katarsis, ndjenjë, emocion, subjekt, mjet shprehes etj. | |

| | |
|---|---|
| teatrore (në të gjitha elementet e veprës). | |
| **Burimet: Teksti Arte/ teatri,** mjete të teknologjisë (CD, regjistrime video). | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>• TIK, letërsia, artet pamore, historia. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metoda dhe teknika: Stuhi mendimi + diskutim, Harta e konceptit, Rrjet diskutimi, Punë e pavarur.**

**ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**

**I.** ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***
**Stuhi mendimi + diskutim.**
- Prezantohet tema e mësimit nga mësuesi/ja: "**Arti, teatri dhe mendimi estetik**"
- Prezantohen nga nxënësit (përmes CD, kompjuterit,) foto, video me fokus natyrën dhe vepra arti.
-Drejtohen nga mësuesi/ja pyetjet:
*Pse i keni zgjedhur? Ç'ndjesi ju kanë krijuar?
*Pse janë të bukura? Ç'është e bukura? Ku gjendet ajo? Si e vlerësoni ju nëse një krijim, një sjellje, një objekt është i bukur apo jo?
*Cila shkencë e studion të bukurën?
*A kanë lidhje e bukura dhe arti?
*Ç'është arti? A quhet art një peizazh natyror i bukur, që nuk e ka krijuar njeriu?
*Si i dallojmë dhe i klasifikojmë artet? Ç'e dallon muzikën nga piktura apo letërsia?
*Ç'tipare të përbashkëta kanë të gjitha llojet e arteve?
*Si do ta përkufizonit, përmes veçorive të tij, teatrin si lloj arti?
Nxënësit shprehen dhe diskutojnë lirisht rreth pyetjeve të mësipërme. Dëgjojnë me vëmendje dhe respektojnë mendimet e të tjerëve.

**II.** ***Ndërtimi i njohurive të reja***
**Harta e konceptit.**
Mbi bazën e përgjigjeve të nxënësve, mësuesja dhe nxënësit ndërtojnë *Hartën e konceptit*



| |
|---|
| **III. Përforcim njohurish;**<br>- Praktikë e drejtuar: Drejtohen pyetjet e tekstit në fund të mësimit. + Si e kuptoni "ARTI - Pasqyrimi artistik i realitetit"?<br><br>- Diskutim: A ndryshojnë shijet për të bukurën nga koha në kohë, nga njëri vendi në tjetrin? Argumentoni mendimin tuaj përmes shembujve nga historia. |
| **IV. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve në:**<br>- përdorimin e saktë në komunikim të kuptimeve të termave dhe shprehjeve: "art", "estetikë", "e bukura në teatër", "katarsis";<br>- ndarjen e përvojave të veta estetike me të tjerët;<br>- shpjegimin e qartë të tipareve të përbashkëta të arteve;<br>- interpretimin e saktë të përjetimeve të veta emocionale të së bukurës në natyrë dhe art;<br>- Vlerësimin e së bukurën përmes përjetimit të një vepre teatrore (në të gjitha elementet e veprës). |
| **V. Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>*- Punohen ushtrimet e rubrikës "Punë kërkimore dhe individuale ose ne grup".*<br>*- Pika 3 do të jetë detyrë me shkrim. Sqarime për detyrën.*<br>*Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.* |

**Data_________________**

**PLANIFIKIMI DITOR 3**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 1: GJUHA DHE KOMUNIKIMI TEATROR**<br><br>**Tema mësimore (3): Teatri dhe mjeti i tij shprehës. Gjuha teatrore** | | **Situata e të nxënit:**<br>Pyetje, diskutim rreth koncepteve, njohurive të marra më parë: "teatri-art', "mjeti artistik i teatrit". | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- shpjegon rolin e mjeteve shprehëse teatrore bazë në kuptimin dhe realizimin e një vepre teatrore;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;<br>- shpjegon qartë tiparet dalluese të teatrit përmes krahasimit të tij me artet e tjera;<br>- interpreton, përmes një gjuhe të saktë, përvojat, | | **Fjalët kyçe:**<br>teatër, mjet artistik, drama, loja e aktorit, spektatori, ndjenjë, emocion, subjekt, natyra kalimtare e teatrit etj. | |

| | |
|---|---|
| përjetimet e veta emocionale;<br>- vlerëson estetikisht shfaqjen teatrale përmes përjetimit dhe përvojave personale. | |
| **Burimet:** Teksti *Arte/ teatri* | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>• letërsi, artet pamore, muzika, historia. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metoda dhe teknika: Stuhi mendimi + diskutim, Harta e konceptit, Rrjet diskutimi, Punë e pavarur.**

**ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**

**I.** ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

A. Kontrolli i detyrës së shtëpisë.

B. Prezantohet tema e mësimit nga mësuesi/ja: “**Teatri dhe mjeti i tij shprehës. Gjuha teatrore**”

C. Stuhi mendimi+ diskutim

Drejtohen nga mësuesi/ja pyetjet:

*Nga vjen fjala “teatër”? Cilat janë elementet e domosdoshme që të realizohet një shfaqje teatrore?
* Pse themi që teatri është art (duke u nisur nga njohuritë e mësimit të mëparshëm; për t’i kontrolluar ato)? Çfarë tiparesh të artit ka ai?
*Si komunikon artistikisht teatri me spektatorin? Cili është mjeti artistik i këtij komunikimi?
* Si do ta përkufizonit teatrin si lloj arti, përmes veçorive të tij?
*Krahasuar me filmin ose arte të tjera, ç’tipare dalluese ka teatri?

Nxënësit shprehen dhe diskutojnë lirshëm rreth pyetjeve të mësipërme. Dëgjojnë me vëmendje dhe respektojnë mendimet e të tjerëve.

**II.** ***Ndërtimi i njohurive të reja***

**Harta e konceptit.**

Mbi bazën e përgjigjeve të nxënësve, mësuesja dhe nxënësit ndërtojnë *Hartën e konceptit* .
Mësuesja sqaron, plotëson njohuritë mbi prejardhjen dhe kuptimin e fjalës “teatër”.



| |
|---|
| **III. Përforcim njohurish;**<br>- Praktikë e drejtuar: Drejtohen pyetjet e tekstit në fund të mësimit.<br>- Përkufizo teatrin, me një fjali, në bazë të mjetit artistik.Përkufizimin më të saktë e vendosim në krye të titullit te *Harta e konceptit.*<br>-Diskutim:Si jeni ndierë në një shfaqje teatrale, krahasuar me shfaqjen e një filmi në kinema? |
| **IV. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve në:**<br>- njohjen e saktë të mjetit artistik;<br>- ndarjen e përvojave të veta estetike me të tjerët;<br>- shpjegimin e qartë të tipareve dalluese të teatrit përmes krahasimit me artet e tjera;<br>- interpretimin e saktë të përvojave, përjetimeve të veta emocionale në lidhje me një shfaqje teatrale;<br>-vlerësimin estetik të një shfaqje teatrore përmes përjetimit dhe përvojave personale. |
| **V. Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>*-U kujtohet nxënësve detyra e ngarkuar që në orën e parë për zgjedhjen e pjesës teatrore që do të vënë në skenë.*<br>*- Nxënësit, të ndarë në 3-4 grupe do të sjellin në CD një fragment të shfaqjes teatrore që ata pëlqejnë të vënë në skenë.Do të diskutojnë dhe do të argumentojnë pse duhet të zgjidhet pjesa e tyre. Kjo detyrë do t'u kërkohet orën 7 të planit, kur do të bëhet ora e parë e projektit "Vënia në skenë e një shfaqje teatrore".* |

**Data__________________**

**PLANIFIKIMI DITOR 4**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 1: GJUHA DHE KOMUNIKIMI TEATROR**<br><br>**Tema mësimore (4): Elementet e teatrit** | | **Situata e të nxënit:**<br>Diskutim rreth përvojave, përjetimeve emocionale të nxënësve, kur kanë vënë në skenë një shfaqje teatrale. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- shpjegon saktë detyrat e secilit element teatror;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;<br>- interpreton, përmes një gjuhe të saktë, përvojat, përjetimet e veta emocionale; | | **Fjalët kyçe:**<br>-teatër, art kolektiv, tekst dramatik, regjisori, aktori, spektatori, elementet pamore, muzika etj. | |

| | |
|---|---|
| - vlerëson estetikisht shfaqjen teatrale përmes përjetimit dhe përvojave personale;<br>- hulumton pjesë dramaturgjike të teatrit shqiptar e botëror. | |
| **Burimet:** Teksti *Arte/ teatri* | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>• letërsi, artet pamore, muzika. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metoda dhe teknika: Rrjeti i diskutimi,** Lexim i pavarur i tekstit, Punë në çift, Ditari dypjesësh **.**

**ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**

**I.** ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

-Prezantohet tema e mësimit nga mësuesi/ja: "**Elementet e teatrit**"

**Rrjeti i diskutimit.**

Besoj se keni vënë në skenë një pjesë teatrale. Cilën pjesë? Si e ndërtuat punën tuaj deri në finalizimin e shfaqjes? Ç'detyrë kishte secili prej jush? Ku e dhatë shfaqjen dhe para kujt? Ç'mësuat nga kjo përvojë? Ç'përjetuat? Ç'fituat në plan shoqëror? Si ju priti publiku? Ç'ndryshoi më pas në jetën tuaj?

Nxënësit shprehen dhe diskutojnë lirshëm rreth pyetjeve të mësipërme. Dëgjojnë me vëmendje dhe respektojnë mendimet e të tjerëve.

**II.** ***Ndërtimi i njohurive të reja***

- Mësuesi/ja pyet nxënësit se ç'kuptojnë me: "TEATRI-ART KOLEKTIV, I PËRBËRË (SINKRETIK)". Sqaron, plotëson kuptimin e tyre.

-Lexim i pavarur i tekstit.

-Punë në çift: Ditari dypjesësh

| Elementet e teatrit | Veçoritë, detyrat |
|---|---|
| I. Dramaturgu, teksti dramatik | |
| II. Publiku | |
| III. Stafi krijues I teatrit: | |
| a.aktori | |
| b. regjisori | |
| c.Elementet pamore (skenografi, kostumografi, grimieri) | |
| d. Muzika, efektet zanore | |
| IV. Prapavija | |
| V. Administrata | |

-Kontrolli i punës në çift

**III. Përforcim njohurish;**

| |
|---|
| -Praktikë e drejtuar: Drejtohen pyetjet e tekstit në fund të mësimit. |
| **IV. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve në:**<br>- shpjegimin e saktë të detyrave të secilit element teatror;<br>- ndarjen e përvojave të veta estetike me të tjerët;<br>- interpretimin e saktë të përvojave, përjetimeve të veta emocionale në lidhje me një shfaqje teatrale;<br>-vlerësimin e estetik të një shfaqje teatrore përmes përjetimit dhe përvojave personale. |
| **V. Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>Shkëpusni një fragment të shkurtër nga një dramë ose komedi nga ato pjesë që po kërkoni për projektin dhe në mënyrë të pavarur, dyshe ose në grupe të vogla mundohuni ta vini në skenë.<br>*Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.* |

**Data**_________________

**PLANIFIKIMI DITOR 5**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 1: GJUHA DHE KOMUNIKIMI TEATROR**<br><br>**Tema mësimore (5): Simbolizmi dhe konvencioni teatror. Rregullat e lojës** | | **Situata e të nxënit:**<br>Diskutim rreth përvojave, përjetimeve emocionale të nxënësve, kur kanë vënë në skenë një shfaqje teatrale. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- evidenton skenat jetësore dhe konvencionin në veprën dramaturgjike;<br>- shpjegon saktë rolin e konvencionit dhe të simbolit në strukturën dramatike;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;<br>- interpreton, përmes një gjuhe të saktë, përvojat, përjetimet e veta emocionale;<br>- vlerëson estetikisht shfaqjen teatrale përmes përjetimit dhe përvojave personale. | | **Fjalët kyçe:**<br>-teatër, simbolizëm, konvencion teatror, muri i katërt, rregulla loje hapësirë, kohë, konflikt dramatik etj. | |
| **Burimet:** Teksti *Arte/ teatri* | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** | |

| | |
|---|---|
| | • letërsi, artet pamore, muzika. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metoda dhe teknika: Diskutim,** Organizuesi grafik i informacionit, Punë në çift, punë e pavarur**.**

**ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**

**I.** ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

-Kontrolli i detyrës së shtëpisë. Nxënsit janë porositur të vënë në skenë një fragment të shkurtër nga një dramë ose komedi. (P.sh: Një fragment nga V. Teli, që është bërë në shkolën 9-vjeçare)

-Prezantohet tema e mësimit nga mësuesi/ja: "**Simbolizmi dhe konvencioni teatror. Rregullat e lojës**"

-Diskutim.

-Si e interpretoni thënien e Pablo Pikasos: "...Arti është një gënjeshtër që na ndihmon të kuptojmë të vërtetën"? Për ç'gënjeshtër e ka fjalën artisti?

-Cili është mjeti artistik që përdor shkrimtari për të përcjellë tek lexuesi mesazhet e veprës së vet? Meqë teatri përbëhet nga teksti letrar, a mund të themi se edhe teatri i përcjell artistikisht idetë, emocionet e veprës teatrore me anë të figurës letrare? Në ç'mënyrë? Konkretizoni përmes shembujve nga teatri.P.sh: A gjejmë simbole në teatër? Konkretizo mendimin tënd (te gjestet, mimika, kostumet etj.).

- Çfarë simbolizuan veshjet tuaja tek fragmenti që interpretuat?

-Çfarë do të simbolizonte një veshje e zezë dhe e bardhë te aktorët?

-Çfarë simbolizuan gjestet e aktorëve?

-Në një shfaqje teatrore ne përjetojmë v një veprim kriminal, por nuk përpiqemi ta ndalojmë atë? Pse?

Atëherë themi se në teatër përdoret konvencioni.

-Ç'kuptoni me fjalën "konvencion" Po në teatër ç'kuptim ka? Çfarë konvencionesh zbulojmë tek interpretimi juaj dhe në përgjithësi në teatër? Konkretizo mendimin tënd.

**II.** ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Organizuesi grafik i informacionit



| |
|---|
| **III. Përforcim njohurish;**<br>-Praktikë e drejtuar: Drejtohen pyetjet e tekstit në fund të mësimit.<br>- Punë në çift ose në grupe të vogla. Veprimtari krijuese: Krijoni dhe interpretoni fragmente të shkurtra përmes simboleve, konvencioneve (mimikës, gjesteve, lëvizjeve, të folurit etj.)<br>(Nxënësit mund të diskutojnë, projektojnë ide rrreth detyrës së shtëpisë). |
| **IV. Vlerësimet do tëbëhen mbi bazën e demonstrimeve në:**<br>- shpjegimin e saktë të konvencionit dhe simbolit në strukturën dramatike;<br>- ndarjen e përvojave të veta estetike me të tjerët;<br>- interpretimin e saktë të përvojave, përjetimeve të veta emocionale në lidhje me një shfaqje teatrale;<br>-vlerësimin e estetik të një shfaqje teatrore përmes përjetimit dhe përvojave personale. |
| **V. Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>Krijoni në mënyrë të pavarur, në çift, grupe të vola një etyd nga një vepër dramatike, ku mjeti kryesor shprehës të jetë simboli. Kjo detyrë do t'u kërkohet pas orës së parë të projektit, i cili do të zhvillohet orën e ardhshme.<br>*Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.* |

**Data_________________**

**PLANIFIKIMI DITOR 6**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 1: GJUHA DHE KOMUNIKIMI TEATROR**<br><br>**Tema mësimore (6): Vepra teatrore dhe dramturgu** | | **Situata e të nxënit:**<br>Diskutim rreth përvojave, përjetimeve emocionale të nxënësve, kur kanë vënë në skenë një shfaqje teatrale. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- shpjegon qartë rolin e dramaturgut;<br>- analizon saktë veprën teatrore në elemente të përmbajtjes dhe të formës artistike;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese.<br>- interpreton ide, përmes një gjuhe të saktë, përvojat, përjetimet e veta emocionale;<br>- vlerëson veprat teatrore sipas autorit, periudhës në të | | **Fjalët kyçe:**<br>-teatër, dramturg, struktura dramatike, fabula, intriga, elementet kompozicinale, konflikti dramatik etj. | |

| | |
|---|---|
| cilën është realizuar, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik. | |
| **Burimet:** Teksti *Arte/ teatri, internet, media etj.* | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>• letërsi, histori, TIK. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metoda dhe teknika:** Kllaster, Diskutim, Organizuesi grafik i informacionit, punë e pavarur**.**

**ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**

**I.** ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

-Prezantohet tema e mësimit nga mësuesi/ja: "**Vepra teatrore dhe dramturgu**"

-Diskutim.

-Cili është roli artistik i dramaturgut në teatër?

-Duke u nisur nga përvojat tuaja në letërsi, nga analizat që u keni bërë veprave letrare, cfarë do të analizonim tek vepra teatrore.

**II.** ***Ndërtimi i njohurive të reja***

1. Kllaster

Përmes përgjigjeve të nxënësve mësuesi/ja plotëson kllasterin




2. Diskutim

Mësuesja drejton pyetjen: Pse është e domosdoshme që të lexojmë me vëmendje dhe ta analizojmë veprën dramatike para se ta vëmë në skenë?

Organizuesi grafik i informacionit




**III. Përforcim njohurish;**

Besoj se keni parë shfaqjen "Romeo dhe Zhulieta" (mësuesja mund të zgjedhë një shfaqje që nxënësit e kanë parë). Le ta analizojmë shfaqjen sipas skemës së mësipërme.

**IV. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve:**

- shpjegon qartë rolin e dramaturgut;
- analizon saktë veprën teatrore në elemente të përmbajtjes dhe të formës artistike;
- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;
- interpreton ide, përmes një gjuhe të saktë, përvojat, përjetimet e veta emocionale;
- vlerëson veprat teatrore sipas autorit, periudhës në të cilën është realizuar, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.

**V. Detyrat dhe puna e pavarur:**

Analizoni sipas skemës së mësipërme shfaqjen teatrale të projektit.

*Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.*

*-Merrni i nformacion nga Interneti mbi tragjedinë . Sqarime për detyrën*

*-U kujtohet nxënësve se orën e ardhshme do të kenë orën e parë të projektit (detyra për të përzgjedhur veprën dramatike që do të vihet në skenë).*

**Data_________________**

**PLANIFIKIMI DITOR 7**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 2: TEKNIKA DHE PROCESE**<br><br>**Tema mësimore (1): Vënia në skenë e një shfaqje teatrale (projekt; ora 1)** | | **Situata e të nxënit:**<br>Diskutim rreth punës hulumtuese për përzgjedhjen e pjesës teatrore që do të vihet në skenë. | |

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>Nxënësi/ja:<br>- Hulumton, shkëmben informacion, bashkëpunon në rrjetet informuese në internet, njeh mjete të ndryshme në funksion të projektit si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.;<br>- përdor ide të ndryshme për të organizuar dhe qartësuar mendimin ose mesazhin që përcjell vepra teatrore;<br>- interpreton veprën duke dhënë emocionet e karakterit të veprës sipas autorit dhe periudhës në të cilën është realizuar vepra;<br>- ndan përvojat e veta interpretuese me të tjerë;<br>- zhvillon aftësitë menaxhuese artistike lidhur me një projekt skenik;<br>- vlerëson veprat teatrore sipas autorit, periudhës në të cilën është realizuar, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.</td><td>Fjalët kyçe:<br>-teatër, tekst dramatik, regjisori, aktori, spektatori, elementet pamore, muzika etj.</td></tr>
<tr><td>Burimet: Teksti Arte/ teatri, CD, DVD, vepra dramatike, Internet, Biblioteka; videoteka</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>• letërsi, artet pamore, muzika, histori.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metoda dhe teknika: Hulumtim, Diskutim, Punë në grupe, Interpretim, Punë në çift, punë e pavarur.</td></tr>
<tr><td colspan="2">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT<br>I. Përshkrimi përmbledhës i veprimtarive kryesore:<br><br>1. Hulumtim<br>Nxënësit, të ndarë në 3-4 grupe, sipas detyrës së dhënë në orën e parë të lëndës, pas kërkimeve në internet, media kanë përzgjedhur veprën dramatike që do të vihet në skenë ( “Pallati 176”; “Kopraci” (Molier); “Shtëpia e kukullës”; (Ibsen), komedi nga Shekspiri etj.). Ata kanë sjellë fragmente prej pjesës dhe argumentojnë zgjedhjen e tyre.<br>2. Diskutim: Zgjedhja e veprës pas dikutimeve në klasë.<br>3. Zgjedhja e regjisorit, asistent regjisorit.<br>3. Formimi i grupeve:<br>a. i aktorëve.</td></tr>
</table>

b. i skenografëve
c. i grimit
d. i kostumografit
dh. i muzikës
e. i fotografit, i kameramanit, i gazetarëve që do të pasqyrojnë projektin
f. i planifikimit ekonomik-administrativ.

3. Sqarime për detyrat e secilit grup.
4. Përshkrimi i produktit të projektit**:**

Në këtë project, ndërveprimi është boshti i veprimtarisë dhe punës në klasë. Nxënësit do të realizojë detyrën e ngarkuar brenda grupit. Mësuesi do të luajë rolin e një lehtësuesi, drejtuesi dhe organizuesi të punës së nxënësit. Lideri i grupit, regjisori, organizon punën si dhe shpërndarjen e detyrave brenda grupit.

5**. Afatet.**

-Në fund të tremujorit të parë nxënësit, sipas detyrave të grupeve, do të kenë siguruar planet, idetë, mjetet e domosdoshme për realizimin e projektit.
-Në fund të tremujorit të dytë do të jepet shfaqja.

**IV. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve:**

- hulumton për të zgjedhur veprën dramatike;
- zbaton drejt e me përgjegjësi detyrat e ngarkuara;
- bashkëpunon me të tjerët;
- përdor ide të ndryshme për të organizuar dhe qartësuar mendimin ose mesazhin që përcjell vepra teatrore;

-interpreton veprën duke dhënë emocionet e karakterit të veprës sipas *autorit dhe periudhës* në të cilën është realizuar vepra;

- përdor drejt mjetet elektronike, digjiitale, në funksion të projektit;
- zhvillon aftësitë menaxhuese artistike;
- vlerëson veprën teatrore, sipas autorit, veprës dhe periudhës në të cilën është realizuar vepra, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.

**V. Detyrat dhe puna e pavarur:**

-1. Leximi i veprës me vëmendje. Sigurimi i tekstit në formë të shkruar dhe digjitale.
2. Të shikohet në media, *youtube* shfaqja e vënë në skenë nga profesionistë.
3. Pas 7 orësh (në orën 14 të planit mësimor të tremujorit të parë) do të diskutohet mbi veprën e zgjedhur. Do te analizohet vepra sipas skemës së analizës në lëndën e letërsisë.
4. Në mënyrë të pavarur dhe në grupet përkatëse, nxënësit përgatisin planet, skicë-idetë mbi, organizimin, mjetet që do të realizojnë shfaqjen, duke dhënë qartë mesazhet dhe emocionet e veprës.

Data________________

**PLANIFIKIMI DITOR 8**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
| **TEMATIKA 1: GJUHA DHE KOMUNIKIMI TEATROR**<br><br>Tema mësimore **(7)**: Zhanret teatrale. Tragjedia | **Situata e të nxënit:**<br>Pyetje rreth llojeve veçorive, teknikave komedisë dhe. |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- dallon zhanre të ndryshme teatrore;<br>- shpjegon, përmes ilustrimeve, tiparet e tragjedisë klasike e moderne;<br>- analizon qartë tiparet e tragjedisë përmes një tragjedie tradicionale;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta teatrore;<br>- interpreton ide, përmes një gjuhe të saktë, përvojat, përjetimet e veta emocionale;<br>- vlerëson veprat teatrore të zhanrit të tragjedisë, duke dhënë gjykim in e vet kritik dhe estetik. | **Fjalët kyçe:**<br>-teatër, këndvështrim, zhanër teatral, tragjedi, hero, tragjik, fat tragjik, komedi, dramë, melodramë, konflikt dramatik etj. |
| **Burimet:** Teksti *Arte/ teatri, Internet, media etj.* | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>• letërsi, histori, TIK |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metoda dhe teknika: Harta e konceptit, praktikë e drejtuar,** punë e pavarur**.**

**ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**

**I.** ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

A. Kontrolli i detyrës së shtëpisë (Analiza e veprës dramatike)

B.Prezantohet tema e mësimit nga mësuesi/ja: "Zhanret teatrale. Tragjedia"

C. Praktikë e drejtuar:

- Si i kemi klasifikuar veprat letrare sipas gjinisë së tyre?
- Po veprat e gjinisë dramatike si i kemi klasifikuar ? Cilat janë veçoritë e secilit lloj?
- Ç'kuptoni me fjalët "këndvështrim" dhe "zhanër teatral"? Ç'lidhje kuptimore ka midis tyre?

**II.** ***Ndërtimi i njohurive të reja***

A. Përmes përgjigjeve të nxënësve mësuesi/ja plotëson, sqaron kuptimet dhe lidhjet e fjalëve "këndvështrim" dhe "zhanër teatral".

*Kuptim i fjalës "këndvështrim":*

1.çfarë shikon nga një vend i veçantë ku je pozicionuar;
2.mënyrë e të menduarit rreth botës; opinion, besim, ide rreth diçkaje.

*Kuptimi i fjalës "zhanër teatral*" (Vjen nga frëngjishtja, që do të thotë "kategori', "tip'. Grup veprash arti, që kanë tipare të përbashkëta, formojnë një tip, kategori që quhet "zhanër". Në teatër veprat klasifikohen në zhanre sipas këndvështrimit serioz ose komik të subjektit).

*Lidhja midis dy koncepteve të mësipërme.*

*Zhanret më të vjetra të gjinisë dramatike: tragjedia dhe komedia.*

- Nga vjen dhe cili është kuptimi fjalës "tragjedi"?
- Kur ka lindur tragjedia? Cili mbahet si babai i saj?
-Cilat janë veçoritë e tragjedisë?

Mbi bazën e përgjigjeve të nxënësve, mësuesi/ja dhe nxënësit ndërtojnë *Hartën e konceptit* plotësojnë, sqarojnë, përmes shembujve, njohuritë.

**B. Harta e konceptit**




**III. Përforcim njohurish;**

Praktikë e drejtuar

Pyetjet e rubrikës "Verifikoni njohuritë"( në tekst).

**IV. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve:**

- dallon zhanre të ndryshme teatrore;
- shpjegon, përmes ilustrimeve, tiparet e tragjedisë klasike e moderne;
- analizon qartë tiparet e tragjedisë përmes një tragjedie tradicionale;
- ndan me të tjerët përvojat e veta teatrore;
- interpreton ide, përmes një gjuhe të saktë, përvojat, përjetimet e veta emocionale;
- vlerëson veprat teatrore të zhanrit të tragjedisë, duke dhënë gjykimin e vet kritik dhe estetik.

| |
|---|
| **V. Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>-Analizoni tiparet e heroi tragjik tek "Romeo dhe Zhulieta" (mësuesja mund të zgjedhë një shfaqje që nxënsit e kenë parë).<br>*-Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.*<br>*-Merrni i nformacion nga Interneti mbi komedinë, llojet, teknikat e saj.* |

**Data_________________**

**PLANIFIKIMI DITOR 9**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 1: GJUHA DHE KOMUNIKIMI TEATROR**<br><br>Tema mësimore **(8)**: Zhanret teatrale.<br>Komedia dhe tragjikomedia | | **Situata e të nxënit:**<br>Pyetje rreth llojeve, veçorive, teknikave të komedisë dhe tragjikomedisë. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- dallon format e ndryshme të komedisë;<br>- shpjegon, përmes ilustrimeve, tiparet dhe teknikat e komedisë dhe tragjikomedisë;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta teatrore;<br>- interpreton artistikisht fragmente komike nga komedi të ndryshme ose i krijon ato nga përvoja, përjetimet e veta emocionale;<br>- vlerëson, përmes shembujve, komedinë dhe tragjikomedinë, duke dhënë gjykimin e vet kritik dhe estetik. | | **Fjalët kyçe:**<br>-teatër, zhanër teatral, komedi, format e komedisë, teknikat e komedisë, shpërfillje e ligjeve natyrore, kontarst mes dukjes dhe thelbit, farsa, satira, tragjikomedi etj. | |
| **Burimet:** Teksti *Arte/ teatri, Interneti* | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>• letërsi, histori, TIK. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**<br>**Metoda dhe teknika: Harta e konceptit, praktikë e drejtuar,** punë e pavarur**.** | | | |

**ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**

**I. *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

A. Kontrolli i detyrës së shtëpisë (Tiparet e hëeroit tragjik në një vepër teatrale të zhanrit të tragjedisë).

B.Prezantohet tema e mësimit nga mësuesi/ja: "Zhanret teatrale. Komedia dhe tragjikomedia"

C. Praktikë e drejtuar + Diskutim

-Cili është këndvështrimi i autorit në komedi, e dukshme kjo përmes subjektit?

- Kur ka lindur komedia? Cili mbahet si babai i komedisë?

-Cilat janë llojet e komedisë?

-Pse qeshim në komedi? Nga buron humori, e qeshura?

-A mund të themi se veprat komike janë më pak serioze se ato tragjike apo dramatike? Pse? Argumentoni mendimin tuaj.

**II. *Ndërtimi i njohurive të reja***

Mbi bazën e përgjigjeve të nxënësve, mësuesi/ja dhe nxënësit ndërtojnë *Hartën e konceptit* plotësojnë, sqarojnë, përmes shembujve, njohuritë.

**Harta e konceptit**




**III. Përforcim njohurish;**

Praktikë e drejtuar:

Pyetjet e rubrikës "Verifikoni njohuritë"( në tekst).

**IV. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve:**

- dallon format e ndryshme të komedisë;
- shpjegon, përmes ilustrimeve, tiparet dhe teknikat e komedisë dhe tragjikomedisë;
- ndan me të tjerët përvojat e veta teatrore;
- interpreton artistikisht fragmente komike nga komedi të ndryshme ose i krijon ato nga përvoja, përjetimet e veta emocionale;

| |
|---|
| - vlerëson, përmes shembujve, komedinë dhe tragjikomedinë, duke dhënë gjykimin e vet kritik dhe estetik. |
| **V. Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>-Shikoni në *Youtube* një komedi të Molierit ("Borgjezi fisnik"). Analizoni si pasqyrohen tiparet e komedisë).<br>*Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.*<br>*- Merrni informacion nga interneti për: emra regjisorësh, detyrat e regjisorëve dhe aktorë të talentuar.* |

**Data__________________**

**PLANIFIKIMI DITOR 10**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 1: GJUHA DHE KOMUNIKIMI TEATROR**<br><br>**Tema mësimore (9): Interpretimi i elementeve të shfaqjes teatrore. Regjisura, drama e shkruar, loja e aktorit.** | | **Situata e të nxënit:**<br>Pyetje rreth qëllimit, detyrave, rëndësisë së elementeve teatrale. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- shpjegon saktë përmes shembujve qëllimin, detyrat, parimet, rëndësinë, vlerat e elementeve teatrore - të gjitha në unitet me njëra-tjetrën;<br>- interpreton, përmes një gjuhe të saktë, përvojat, përjetimet e veta emocionale;<br>- vlerëson rolin e secilit element teatror në ansamblin e shfaqjes teatrore. | | **Fjalët kyçe:**<br>-teatër, tekst dramatik, regjisor, aktor, interpretim, ansambël skenik, publik, perceptim, detyra skenike etj. | |
| **Burimet:** Teksti *Arte/ teatri, Internet* | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>• letërsi, artet pamore, muzika, histori, qytetari. | |

| |
|---|
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**<br>**Metoda dhe teknika:** Praktikë e drejtuar, Punë në grupe, Lexim i pavarur i tekstit, Diskutim. |
| **ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**<br>**I. *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***<br>A. Prezantohet tema e mësimit nga mësuesi/ja: "**Interpretimi i elementeve të shfaqjes teatrore Regjisura, drama e shkruar, loja e aktorit".**<br>B. Praktikë e drejtuar (Rikujtohen njohuritë e marra mbi elementet teatrore)+ Kontrolli i detyrës së shtëpisë (informacion mbi regjisorin dhe aktorin):<br>-Cilat janë elementet e shfaqjes teatrore?<br>-Cilat janë qëllimet, detyrat, roli, rëndësia në ansamblin e shfaqjes teatrore e: regjisorit, aktorit, tekstit dramatik?<br>**II. *Ndërtimi i njohurive të reja***<br>A. Punë në grupe + Lexim i pavarur i tekstit.<br>Nxënësit, të ndarë në grupe, lexojnë në heshtje tekstin. Të mbështetur në tekst dhe në informacionet e marra nga Interneti, nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin dhe ndërtojnë njohuritë. Në fund drejtuesi i grupit paraqet interpretimet e grupit.U kërkohet nxënësve që interpretimet e tyre t'i ilustrojnë me shembuj nga shfaqjet teatrale. Secili grup interpreton elementet teatrore në këto aspekte: qëllimi, detyrat, parimet mbi të cilat ndërtohen elementet teatrore, rëndësia, vlerat - të gjitha në unitet me njëra-tjetrën, pa të cilën nuk mund të ketë shfaqje teatrore.<br>Grupi I: Loja e aktorëve, elementet pamore dhe muzikore;<br>Grupi II: Drama e shkruar, regjisura;<br>Grupi III: Domethënia e shfaqjes.Teatri dhe rrethanat historiko-shoqërore<br>-B. Kontrolli i punës me grupe<br>**III. Përforcim njohurish;**<br>-Diskutim: Pse është e domosdoshme që elementet teatrore të punojnë në unitet me njëra-tjetrën? |
| **IV. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve në:**<br>- shpjegon saktë përmes shembujve qëllimin, detyrat, parimet, rëndësinë, vlerat e elemeneteve teatrore -të gjitha në unitet me njëra-tjetrën;<br>- interpreton, përmes një gjuhe të saktë, përvojat, përjetimet e veta emocionale;<br>- vlerëson rolin e secilit element teatror në ansamblin e shfaqjes teatrore; |
| **V. Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>**-**Mësuesja dhe nxënësit organizojnë ndjekjen e një shfaqje tetrale në teatrin e qytetit. Më pas ,nxënësit, sipas grupeve, analizojnë elementet teatrore.<br>*Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.* |

Data________________

**PLANIFIKIMI DITOR 11**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 1 (10): GJUHA DHE KOMUNIKIMI TEATROR**<br><br>**Tema mësimore: Interpretimi i elementeve të shfaqjes teatrore. Elementet pamore dhe muzikore. Teatri dhe rrethanat historike e shoqërore.** | | **Situata e të nxënit:**<br>Pyetje rreth qëllimit, detyrave, rëndësisë së elementeve teatrale (pamore dhe muzikore) dhe rrethanave historiko-shoqërore. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- shpjegon saktë përmes shembujve qëllimin, detyrat, parimet, rëndësinë, vlerat e elemeneteve teatrore (pamore dhe muzikore) -të gjitha në unitet me njëra-tjetrën;<br>- shpjegon saktë përmes shembujve lidhjen mes teatrit rrethanatve historike e shoqërore;<br>- interpreton, përmes një gjuhe të saktë, domethënien e shfaqjes teatrore;<br>- vlerëson rolin e secilit element në ansamblin e shfaqjes teatrore. | | **Fjalët kyçe:**<br>-teatër, tekst dramatik, spektatori, elementet pamore, muzika, domethënia e shfaqjes, rrethanat historike e shoqërore etj. | |
| **Burimet:** Teksti *Arte/ teatri, Internet* | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>• letërsi, artet pamore, muzika, histori, qytetari. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**<br>**Metoda dhe teknika:** Praktikë e drejtuar, Punë në grupe, Lexim i pavarur i tekstit, Diskutim. | | | |
| **ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**<br>**I.** ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***<br>A. Prezantohet tema e mësimit nga mësuesi/ja: "**Interpretimi i elementeve të shfaqjes teatrore Elementet pamore dhe muzikore. Teatri dhe rrethanat historike e shoqërore"**<br>B. Praktikë e drejtuar mbi bazën e Kontrollit të detyrës së shtëpisë (Nxënësit analizojnë elementet teatrore te shfaqja teatrore që kanë parë).<br>-Cilat janë qëllimet, detyrat, roli, rëndësia e elementeve pamore dhe muzikore në ansamblin e shfaqjes teatrore?<br>-Shpjegoni marrëdhënien midis teatrit dhe shoqërisë, historisë.<br>**II.** ***Ndërtimi i njohurive të reja*** | | | |

| |
|---|
| A. Punë në grupe + Lexim i pavarur i tekstit.<br>Nxënësit, të ndarë në grupe, lexojnë në heshtje në tekst interpretimet mbi elementet teatrore që u janë dhënë si detyrë. Më pas diskutojnë me njëri-tjetrin. Në fund drejtuesi i grupit paraqet interpretimet e grupit.U kërkohet nxënësve që interpretimet e tyre t'i ilustrojnë me shembuj nga shfaqjet teatrale. Secili grup interpreton elementet teatrore në këto aspekte: qëllimi, detyrat, parimet mbi të cilat ndërtohen elementet teatrore, rëndësia, vlerat - të gjitha në unitet me njëra-tjetrën, pa të cilën nuk mund të ketë shfaqje teatrore.<br>Grupi I: Elementet pamore + muzikore;<br>Grupi II:Teatri dhe rrethanat historiko-shoqërore;<br>Grupi III: Domethënia e shfaqjes.<br>-B. Kontrolli i punës me grupe<br>**III. Përforcim njohurish;**<br>Diskutim: A ju ka ndodhur që nuk ju ka pëlqyer shfaqja teatrore? Pse? Kur një shfaqje teatrore nuk pëlqehet nga publiku? |
| **IV. bëhen mbi bazën e demonstrimeve në:**<br>- shpjegon saktë përmes shembujve qëllimin, detyrat, parimet, rëndësinë, vlerat e elemeneteve teatrore (pamore dhe muzikore) -të gjitha në unitet me njëra-tjetrën;<br>- shpjegon saktë përmes shembujve lidhjen midis teatrit dhe rrethanave historike e shoqërore;<br>- interpreton, përmes një gjuhe të saktë, domethënien e shfaqjes teatrore;<br>- vlerëson rolin e secilit element në ansamblin e shfaqjes teatrore. |
| **V. Detyrat dhe puna e pavarur: Analizoni te shfaqja që patë në teatër elementet teatrore që studiuam sot. Sqarime.**<br>*Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.* |

**Data_________________**

**PLANIFIKIMI DITOR 12**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 2: TEKNIKA DHE PROCESE**<br><br>Tema mësimore (2): HYRJE.<br>Veçori të punës në teatër | | **Situata e të nxënit:**<br>Pyetje: Ku qëndron çelësi i suksesit të një shfaqjeje teatrore? | |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- shpreh qartë mendime, ndjenja, ide rreth teatrit dhe përvojave teatrore, si një punë që kërkon studim, stërvitje, disiplinë, shpirt bashkëpunimi;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;<br>- interpreton saktë thënie, shprehje që lidhen me punën në teatër;<br>- vlerëson moton e punës së tyre krijuese: "Rëndësi ka procesi dhe jo rezultati', të cilën do ta zbatojnë gjatë përgatitjes dhe vënies në skenë të shfaqjes së tyre. | **Fjalët kyçe:**<br>-teatër, shfaqje teatrore, studim, stërvitje, disiplinë, shpirt bashkëpunimi, moto, regjisor, actor, interpretim, skenograf, kostumograf etj. |
| **Burimet:** Teksti *Arte/ teatri, Interneti* | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>• letërsi, Qytetari, TIK |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metoda dhe teknika:** Kllaster+ diskutim, punë në grupe.

**ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**

**I.** ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

A. Kontrolli i detyrës së shtëpisë.

B.Prezantohet tema e mësimit nga mësuesi/ja: "Veçori të punës në teatër "

C. Stuhi mendimesh;

-Ku qëndron çelësi i suksesit të një shfaqjeje teatrore?

**II.** ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Kllaster + diskutim

Përmes përgjigjeve të nxënësve mësuesi/ja plotëson kllasterin. Mësuesja pranon çdo mendim të nxënësve që lidhet me çështjen.




Nxënësit, përmes shembujve nga përvojat personale dhe të tjerëve, të profesionistëve, diskutojnë, mbrojnë mendimet, idetë, mbresat, që sollën gjatë plotësimit të kllasterit.

| |
|---|
| **III. Përforcim njohurish;**<br>Shkruhet në dërrasë shprehja: "Motoja jonë: "Rëndësi ka procesi dhe jo rezultati"<br>Diskutim: Si e kuptoni shprehjen: "Motoja jonë: "Rëndësi ka procesi dhe jo rezultati"? |
| **IV. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve:**<br>- shpreh qartë mendime, ndjenja, ide rreth teatrit dhe përvojave teatrore, si një punë që kërkon studim, stërvitje, disiplinë, shpirt bashkëpunimi;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;<br>- interpreton saktë thënie, shprehje që lidhen me punën në teatër;<br>-vlerëson moton e punës së tyre krijuese: "Rëndësi ka procesi dhe jo rezultati', të cilën do ta zbatojnë gjatë përgatitjes dhe vënies në skenë të shfaqjes së tyre. |
| **V. Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>Punë në grupe. Analizoni, sipas skemës së dhënë më parë, veprën që do të vihet në skenë (Projekti). (Nxënësit, për të realizuar detyrën, mund të lexojnë tekstin në faqen 37-38.) Sqarime për detyrën.<br>Grupi I: Prezantimi i veprës.<br>Analizë e: jetës dhe veprës së autorit, e rrethanave historiko-shoqërore-kulturore-artistike në të cilat është krijuar vepra, e gjinisë, zhanrit etj.<br>Grupi II: Pse e ka shkruar veprën autori? Qëllimet e tij. Analizë e përmbajtjes tematike-ideore.<br>Grupi III: Analizë e subjektit, e rrethanave historiko-shoqërore në të cilën ndodh ngjarja.<br>Grupi IV: Analizë e personazheve, karaktereve të tyre.<br>*Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.* |

**Data__________________**

**PLANIFIKIMI DITOR 13**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 2: TEKNIKA DHE PROCESE**<br><br>Tema mësimore (3): Faza parapërgatitore. Procese të analizës dhe të interpretimit të pjesës. | | **Situata e të nxënit:**<br>Pyetje:<br>-Pse duhet të analizohet vepra që do të shfaqet në skenë?<br>-Cilat janë elementet e domosdoshme të kësaj analize? | |

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>Nxënësi/ja:<br>- shpreh qartë mendime, ndjenja, ide rreth veprës;<br>- analizon qartë elemente të veprës dramatike;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;<br>- vlerëson veprën dramatike përmes gjykimeve të tij artistike-kritike.</td><td>Fjalët kyçe:<br>-teatër, shfaqje teatrore, autori, rrethana historiko-shoqërore-kulturore-artistike, gjini, zhanri, përmbajtja tematike-ideore, personazh, karakter, vlera të veprës etj.</td></tr>
<tr><td>Burimet: Teksti Arte/ teatri, Interneti</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>• letërsi, Qytetari, TIK.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metoda dhe teknika: Diskutim i punës së grupeve</td></tr>
<tr><td colspan="2">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT<br>I. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve<br>A. Prezantohet tema e mësimit nga mësuesi/ja: “Procese të analizës dhe të interpretimit të pjesës”.<br>B. Stuhi mendimesh:<br>- Pse duhet të analizohet vepra që do të shfaqet në skenë?<br>-Cilat janë elementet e domosdoshme të kësaj analize?<br>II. Ndërtimi i njohurive të reja<br>Diskutim i punës së grupeve (mbi bazën e detyrës së shtëpisë).<br>Grupi I: Prezantimi i veprës.<br>Analizë e: jetës dhe veprës së autorit, e rrethanave historiko-shoqërore-kulturore-artistike në të cilat është krijuar vepra, e gjinisë, zhanrit etj.<br>Grupi II: Pse e ka shkruar veprën autori? Qëllimet e tij. Analizë e përmbajtjes tematike-ideore.<br>Grupi III: Analizë e subjektit, e rrethanave historike-shoqërore në të cilën ndodh ngjarja.<br>Grupi IV: Analizë e personazheve, karaktereve të tyre.<br>III. Përforcim njohurish;<br>Diskutim: Cilat janë vlerat e veprës?</td></tr>
<tr><td colspan="2">IV. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve:<br>- shpreh qartë mendime, ndjenja, ide rreth veprës;<br>- analizon qartë elemente të veprës dramatike;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;<br>-vlerëson veprën dramatike përmes gjykimeve të tij artistiko-kritike.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| **V. Detyrat dhe puna e pavarur: Organizoni një takim, bisedë me një regjisor, i cili do t'ju flasë rreth punës regjisoriale.**<br>-Nxënësit, individualisht dhe në grupe, do të vazhdojnë të realizojnë detyrat e ngarkuara të projektit.<br>**-Organizoni një takim, bisedë me një regjisor, i cili do t'ju flasë rreth punës regjisoriale.**<br>*Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.* |

**Data________________**

**PLANIFIKIMI DITOR 14**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 2: TEKNIKA DHE PROCESE**<br><br>Tema mësimore (4): Procese të interpretimit dhe konceptit regjisorial. Stili i shfaqjes (1) | | **Situata e të nxënit:**<br>Pyetje:<br>-Cili është roli i regjisorit në shfaqjen teatrore?<br>-Pse regjisorët, sjellin këndvështrime të ndryshme për të njëjtën vepër dramtike? | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- shpjegon saktë përmes shembujve qëllimin, detyrat e një regjisori;<br>- interpreton, përmes një gjuhe të saktë, konceptet, vizionet regjisoriale të një shfaqje teatrore;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;<br>- vlerëson rolin e regjisorit si dirgjenti që harmonizon të gjitha komponentët e shfaqjes. | | **Fjalët kyçe:**<br>-regjisor, platformë regjisoriale, koncept, vizion regjisorial, shfaqje teatrore, stil i shfaqjes, zgjedhja e aktorëve etj. | |
| **Burimet:** Teksti *Arte/ teatri, Interneti* | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>• letërsi, arte pamore, arte muzikore, TIK. | |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metoda dhe teknika:** Stuhi mendimesh, Organizuesi grafik i informacionit, Praktikë e drejtuar.

**ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**

**I.** ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

A. Prezantohet tema e mësimit nga mësuesi/ja: "Procese të interpretimit dhe konceptit regjisorial. Stili i shfaqjes".
(Mësimi mund të zhvillohej edhe në formë bisede me një regjisor.)
B. Stuhi mendimesh:
-Cili është roli i regjisorit në shfaqjen teatrore? Cilat janë detyrat e tij?
- E njëjta vepër teatrore nga regjisorë të ndryshëm vjen në skenë në këndvështrime të ndryshme? Jepni shembuj.
Shembuj:
"Hamleti" klasik, në pranverën e vitit 2016, në Teatrin Eksperimental, erdhi në një këndvështrim modern, nga regjisori Enke Fezollari. Një Hamlet pa gjini, i luajtur nga një femër-kështu e koceptoi regjisori këtë shfaqje të largët në histori, duke i folur aktualitetit të sotëm.
Hamleti "*…Është një intelektual, një revolucionar në Danimarkën e kalbur dhe sidomos në një Europë, e cila po shembet, një Europë, e cila nuk mund të zgjidhë problemet e saj, njerëzit janë duke u mbytur në Mesdhe, luftërat ekonomike… Kështu dhe Hamleti, jeton në Danimarkë, e cila është e etur për luftë dhe pushteti është duke kryer krime. Një Hamlet i cili nuk do të ndryshojë për botën, por bota të ndryshojë për të. Një shoqëri ku vlerat e dashurisë janë si hipodromi apo si bursa. Me politikanë oportunistë, ku jetët njerëzore nuk janë veçse një parametër i luftës së tyre për pushtet. Ky është ferri që jeton Hamleti. Hamleti, njeriu i parë bashkëkohor, me ide dhe vlera, kundër pushtetit të Klaudit dhe Polonit ... ecën në shoqërinë e kalbur të "Danimarkës". Historia tragjike e Princit Hamlet, është ngjitja e tij në majat më të larta hermetike dhe të pakalueshme për të nxjerrë një dritë verbuese të përjetshme dhe ne jemi të dënuar brenda hijes së tij, të përshkruajmë formën e tij. Nën përkthimin e Fan Nolit kjo vepër erdhi nën një konceptim ndryshe nga regjisori Fezollari duke e vendosur një aktore karriere si: Luiza Xhuvani përkrah aktorëve të rinj, si: Andi Begolli, Endri Çela, Julinda Emiri, Anderson Gurra, Ina Gjoni, Laura Nezha, Ermir Jonka, Ilia Kaçi, Kristian Koroveshi...",* do të shprehej regjisori Fezollari për konceptin skenik të veprës. (Marrë nga gazeta "Shqip';19 mars 2016).
P.sh.:Komedia "Karnavalet e Korçës" është trajtuar si një festë karnavalesh që vjen nga jashtë si një atmosferë e hareshme, në kontrast me varfërinë shpirtërore të një familje të pasur. Pra shfaqja konceptohet, ndërtohet mbi bazën e një kontrasti, antiteze.

-Pse regjisorët sjellin këndvështrime të ndryshme për të njëjtën vepër dramtike? Nga nisen? Cili është qëllimi?

**II.** ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Organizuesi grafik i informacionit




Nxënësit, përmes shembujve nga përvojat personale dhe të profesionistëve, diskutojnë mendime, ide, mbresa, sjellin shembuj rreth çështjes.

**III. Përforcim njohurish;** Praktikë e drejtuar.

Pyetjet e rubrikës "Verifikoni njohuritë" (në tekst).

**IV. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve:**

- shpjegon saktë përmes shembujve qëllimin, detyrat e një regjisori;
- interpreton, përmes një gjuhe të saktë, konceptet, vizionet regjisoriale të një shfaqje teatrore;
- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;
-vlerëson rolin e regjisorit si dirgjenti që harmonizon të gjitha komponentët e shfaqjes.

**V. Detyrat dhe puna e pavarur:**

Veprimtari dhe punë kërkimore individuale ose në grup (në tekst):

Përpiloni me shkrim platformën regjisoriale të shfaqjes suaj të ardhshme.

*Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.*

**Data**________________

**PLANIFIKIMI DITOR 15**

<table>
<tr><td>Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror</td><td>Lënda: Arte</td><td>Shkalla: V</td><td>Klasa: X</td></tr>
<tr><td colspan="2">TEMATIKA 2: TEKNIKA DHE PROCESE<br><br>Tema mësimore (5): Procese të interpretimit dhe konceptit regjisorial. Stili i shfaqjes (2)</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>- Regjisori dhe asistentë regjisorët prezantojnë vizionin, konceptin regjisorial, stilin, platformën regjisoriale të shfaqjes teatrore që nxënësit do të vënë në skenë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:<br>Nxënësi/ja:<br>- interpreton, përmes një gjuhe të saktë, konceptet, vizionet regjisoriale të shfaqjes teatrore që do të japin;<br>- ndërton, në bashkëpunim me të tjerë, ide, platforma për detyrën e ngarkuar në grup për përgatitjen e shfaqjes teatrore;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;<br>- Vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe të bashkëpunimit në grup, për realizimin e qëllimit kryesor; vënien në skenë të shfaqjes teatrore.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>-regjisor, platformë regjisoriale, koncept, vizion regjisorial, shfaqje teatrore, stil i shfaqjes, zgjedhja e aktorëve, skenografia, kostumografia, muzika etj.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti Arte/ teatri, Interneti</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>• letërsi, Arte pamore, arte muzikore, TIK.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metoda dhe teknika: Dikutim, punë në grupe.</td></tr>
<tr><td colspan="4">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT<br>I. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve<br>-Regjisori dhe asistentë regjisorët prezantojnë vizionin, konceptin regjisorial, stilin e shfaqjes teatrore që nxënësit do të vënë në skenë, platformën e tyre regjisoriale.<br>II. Ndërtimi i njohurive të reja<br>Diskutim i punës individuale dhe në grup i detyrës së shtëpisë.<br>Sipas konceptit dhe platformës regjisoriale, nxënësit, të ndarë në grupe, diskutojnë me regjisorin dhe asistentë regjisorët rreth ideve të ndërtimit të elementeve teatrore të shfaqjes që do të japin.<br>-Regjisori dhe asistentë regjisorët, në bashkëpunim me grupin e aktorëve, zgjedhin aktorët e përshtatshëm sipas roleve.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| -Më pas diskutohet për idetë e ndërtimit të elementeve teatrorë të grupeve të skenografëve, grimit, kostumografëve, muzikës etj. |
| **III. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve:**<br>- interpreton, përmes një gjuhe të saktë, konceptet, vizionet regjisoriale të shfaqjes teatrore që do të japin;<br>- ndërton, në bashkëpunim me të tjerë, ide, platforma për detyrën e ngarkuar në grup për përgatitjen e shfaqjes teatrore;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;<br>- vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe të bashkëpunimit në grup, për realizimin e qëllimit kryesor: vënien në skenë të shfaqjes teatrore. |
| **IV. Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>Veprimtari dhe punë kërkimore individuale ose në grup:<br>Nxënësit do të vazhdojnë me detyrat e tyre sipas grupeve të projektit. Orën e ardhshme do të diskutohet për skenografinë dhe kostumografinë e shfaqjes teatrore.<br>*Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.* |

**Data__________________**

**PLANIFIKIMI DITOR 16**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 2: TEKNIKA DHE PROCESE**<br><br>Tema mësimore (6): Procese dhe elemente pamore (1) | | **Situata e të nxënit:**<br>Pyetje: Cilat janë detyrat e skenografit/ kostumografit? Pse është i rëndësishëm roli i skenografit/ kostumografit në shfaqjen teatrore? | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- shpjegon saktë përmes shembujve qëllimin,detyrat e një skenografi dhe kostumografi dhe veçoritë e punës së tyre;<br>- interpreton, përmes një gjuhe të saktë, konceptet, vizionet regjisoriale në lidhje me skenografinë dhe kostumografinë e shfaqjes së tyre teatrore;<br>- ndërton, në bashkëpunim me të tjerë, ide, platforma për | | **Fjalët kyçe:**<br>platformë regjisoriale, skenografi, kostumografi, funksionale, shprehëse, kohë, vend, veprim, subjekt, karakter, stil pamor, realist, jorealist, llojet e skenave etj. | |

| | |
|---|---|
| skenografinë dhe kostumografinë e shfaqjes së tyre teatrore;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;<br>-vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe të bashkëpunimit në grup, për realizimin e qëllimit kryesor, vënien në skenë të shfaqjes teatrore. | |
| **Burimet:** Teksti *Arte/ teatri, Interneti* | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>• letërsi, Arte pamore, arte muzikore, TIK. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metoda dhe teknika:** Stuhi mendimesh, Punë e pavarur: Lexim i pavarur i tekstit + mbajtja e strukturuar e shënimeve

**ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**

**I.** ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

A. Prezantohet tema e mësimit nga mësuesi/ja: "Procese dhe elemente pamore".
B. Stuhi mendimesh:
-Cilat janë detyrat e skenografit? Pse është i rëndësishëm roli i skenografit në shfaqjen teatrore? Si duhet të ndërtohet skena në një shfaqje teatrore?
-Cilat janë detyrat e kostumografit? Pse është i rëndësishëm roli i kostumografit në shfaqjen teatrore?
- Si duhet të zgjidhen kostumet në një shfaqje teatrore?

**II.** ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Punë e pavarur: Lexim i pavarur i tekstit + mbajtja e strukturuar e shënimeve

Mbajtja e strukturuar e shënimeve



| |
|---|
| Nxënësit, përmes shembujve nga përvojat personale dhe të profesionistëve, diskutojnë mendime, ide, mbresa, sjellin shembuj rreth çështjes.<br>**III. Përforcim njohurish;** Praktikë e drejtuar.<br>Pyetjet e rubrikës "Verifikoni njohuritë" (në tekst). |
| **IV. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve:**<br>- shpjegon saktë përmes shembujve qëllimin,detyrat e një skenografi dhe kostumografi dhe veçoritë e punës së tyre;<br>- interpreton, përmes një gjuhe të saktë, konceptet, vizionet regjisoriale në lidhje me skenografinë dhe kostumografinë e shfaqjes së tyre teatrore;<br>- ndërton, në bashkëpunim me të tjerë, ide, platforma për skenografinë dhe kostumografinë e shfaqjes së tyre teatrore;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta interpretuese, realizuese;<br>- vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe të bashkëpunimit në grup, për realizimin e qëllimit dhe të bashkëpunimit në grup, për realizimin e qëllimit kryesor: vënien në skenë të shfaqjes teatrore. |
| **V. Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>Veprimtari dhe punë kërkimore individuale ose në grup (në tekst)<br>-Punë në grupe. Grupi I: ndërton maketin e skenografisë; Grupi II: skicon kostumet e shfaqjes.<br>*Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.* |

**Data**__________________

**PLANIFIKIMI DITOR 17**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 2: TEKNIKA DHE PROCESE**<br><br>Tema mësimore (7): Procese dhe elemente pamore (2) | | **Situata e të nxënit:**<br>Nxënësit prezantojnë maketet e skenografisë, si dhe skicat e kostumeve të shfaqjes së tyre | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- ndërton, në bashkëpunim me të tjerë, platforma, makete, për skenografinë dhe kostumografinë e shfaqjes teatrore që do të vihet në skenë;<br>- interpreton anët funksionale dhe shprehëse (përmes një gjuhe të saktë), platformat, maketet skenografike dhe | | **Fjalët kyçe:**<br>platformë regjisoriale, skenografi, kostumografi, funksionale, shprehëse, kohë, vend,veprim, subjekt, karakter, stil pamor, realist, jorealist, llojet e skenave etj. | |

| | |
|---|---|
| kostumografike të shfaqjes teatrore që do të japin;<br>- ndan me të tjerët përvojat e veta realizuese;<br>- vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe të bashkëpunimit në grup, për realizimin e qëllimit kryesor, vënien në skenë të shfaqjes teatrore. | |
| **Burimet:** Teksti *Arte/ teatri, Interneti* | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>• letërsi, Arte pamore, arte muzikore, TIK. |

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**
**Metoda dhe teknika:** Dikutim, punë në grupe.

**ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**

**I. *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***
-Regjisori dhe asistentë regjisorët prezantojnë vizionin, konceptin regjisorial, stilin e shfaqjes teatrore që nxënësit do të vënë në skenë, platformën e tyre regjisoriale.

**II. *Ndërtimi i njohurive të reja***
Diskutim i punës individuale dhe në grup i detyrës së shtëpisë.
Sipas konceptit dhe platformës regjisoriale, nxënësit, të ndarë në grupe, prezantojnë maketet e skenografisë, si dhe skicat e kostumeve të shfaqjes së tyre. Nxënësit, përmes shembujve nga përvojat personale dhe të profesionistëve, diskutojnë, mendime, ide, mbresa, sjellin shembuj rreth çështjes. Pas diskutimeve nxënësit zgjedhin maketin dhe skicat ekostumeve më të mira nga ana funksionale dhe shprehëse.

**III. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve:**
- ndërton, në bashkëpunim me të tjerë, platforma, makete, për skenografinë dhe kostumografinë e shfaqjes teatrore që do të vihet në skenë;
- interpreton anët funksionale dhe shprehëse (përmes një gjuhe të saktë), platformat, maketet skenografike dhe kostumografike të shfaqjes teatrore që do të japin;
- ndan me të tjerët përvojat e veta realizuese;
- vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe të bashkëpunimit në grup, për realizimin e qëllimit kryesor: vënien në skenë të shfaqjes teatrore.

**IV. Detyrat dhe puna e pavarur:**
Veprimtari dhe punë kërkimore individuale ose në grup (në tekst)
- Punë në grupe. Nxënësit do të vazhdojnë me detyrat sipas grupeve të projektit. (Orën e ardhshme do të diskutohet për procesin e provave. Regjisori dhe asistentë regjisorët do të punojnë me provat e aktorëve. Aktorët duhet të kenë tekstin përpara dhe të përgatiten për fragmente interpretimesh nga shfaqja.)
*Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.*

**Data**________________

**PLANIFIKIMI DITOR 18**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 2: TEKNIKA DHE PROCESE**<br><br>Tema mësimore (8): Procesi i provave (1) | | **Situata e të nxënit:**<br>Pyetje: Si do t'i organizojmë provat e shfaqjes? | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- Nën drejtimin e grupit të regjisorëve, interpreton artististikisht (vetëm, në çift ose në grup), fragmente nga shfaqja teatrore që do të vihet në skenë, dukje sjellë kuptimin e qartë të saj;<br>- interpreton idetë e veta, duke komunikuar artistikisht dhe estetikisht mbi veprën teatrore;<br>**-** ndan përvojat e veta interpretuese dhe realizuese me të tjerë;<br>- reflekton emocionet që i krijon një vepër skenike gjatë kohës që interpretohet,<br>- vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe të bashkëpunimit në grup. | | **Fjalët kyçe:**<br>platformë regjisoriale, aktor, interpretim, prova,funksionale,shprehëse, kohë, vend,veprim, subjekt, karakter, mizanskenë etj. | |
| **Burimet:** Teksti *Arte/ teatri, Interneti* | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>• letërsi, Arte pamore, arte muzikore, TIK. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**<br>**Metoda dhe teknika:** Dikutim, punë në grupe. | | | |

**ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT**

**I.** ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***

**Diskutim**

-Si do t'i organizojmë provat e shfaqjes?

**II.** ***Ndërtimi i njohurive të reja***

Nxënësit, përmes shembujve nga përvojat personale dhe të profesionistëve, diskutojnë, mendime, ide, sjellin shembuj rreth çështjes.

1. Nxënësit duhet të arrijnë në përfundimie se:

- duhet të punojnë nën drejtimin e grupit të regjisorëve, për të përcjellë përmes interpretimeve të veta idetë, mesazhet e veprës, ndjenjat, emocionet e saj, duke sjellë karaktere të gjalla që lëvizin në një kohë, në një vend dhe në rrethana të caktuara shoqërore;

| |
|---|
| - nuk duhet të jenë egoistë, por të punojnë në ansambël, duke përsëritur moton e punës së tyre krijuese: “Rëndësi ka procesi dhe jo rezultati”;<br>- të hartojnë dhe të zbatojnë me përgjegjësi, me vullnet planin e provave;<br>- të zbatojnë me përgjegjësi dhe përpikëri detyrat, afatet.<br>2. Diskutohet me nxënësit për llojet e provave dhe koha që u duhet kushtuar (prova në tavolinë, provat në lëvizje ose në mizanskenë, prova të lidhura, provat gjenerale etj.) |
| **III. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve:**<br>- nën drejtimin e grupit të regjisorëve interpreton artististikisht (vetëm, në çift ose në grup), fragmente nga shfaqja teatrore që do të vihet në skenë, dukje sjellë kuptimin e qartë të saj;<br>- interpreton idetë e veta, duke komunikuar artistikisht dhe estetikisht mbi veprën teatrore;<br>- ndan përvojat e veta interpretuese dhe realizuese me të tjerë;<br>-reflekton emocionet që i krijon një vepër skenike gjatë kohës që interpretohet;<br>- vlerëson rëndësinë e punës individuale. |
| **IV. Detyrat dhe puna e pavarur:**<br>Veprimtari dhe punë kërkimore individuale ose në grup (në tekst)<br>-Punë në grupe. Nxënësit do të vazhdojnë me detyrat sipas grupeve të projektit. Orën e ardhshme do të punohet për procesin e provave.<br>*Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.* |

**Data_________________**

**PLANIFIKIMI DITOR 19**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|
| **TEMATIKA 2: TEKNIKA DHE PROCESE**<br>Tema mësimore (9): Procesi i provave (2) | | **Situata e të nxënit:**<br>Pyetje: A jeni të qartë mbi interpretimin artistik, mbi lëvizjet, tiparet e karaktereve të personazheve të shfaqjes suaj teatrore? | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:**<br>Nxënësi/ja:<br>- nën drejtimin e grupit të regjisorëve interpreton artististikisht (vetëm, në çift ose në grup), fragmente nga shfaqja teatrore që do të vihet në skenë, dukje sjellë kuptimin e qartë të saj;<br>- interpreton idetë e veta, duke komunikuar artistikisht dhe estetikisht mbi veprën teatrore; | | **Fjalët kyçe:**<br>platformë regjisoriale, aktor, interpretim, prova,funksionale,shprehëse, kohë, vend,veprim, subjekt, karakter, mizanskenë etj. | |

<table>
<tr><td>- ndan përvojat e veta interpretuese dhe realizuese me të tjerë;<br>- reflekton emocionet që i krijon një vepër skenike gjatë kohës që interpretohet;<br>- vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe të bashkëpunimit në grup.</td><td></td></tr>
<tr><td>Burimet: Teksti Arte/ teatri, Interneti</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>• letërsi, Arte pamore, arte muzikore, TIK.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve<br>Metoda dhe teknika: Dikutim, punë e pavarur, punë në çift, punë në grupe.</td></tr>
<tr><td colspan="2">ZHVILLIMI I ORËS SË MËSIMIT<br>I. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve<br>Diskutim (drejtuar nga regjisori)<br>- A jeni të qartë mbi interpretimin artistik, mbi lëvizjet, tiparet e karaktereve të personazheve?<br>II. Ndërtimi i njohurive të reja<br>Dikutim, punë e pavarur, punë në çift, punë në grupe.<br>-Pas diskutimeve, sqarimeve për pyetjen e drejtuar më sipër nga regjisori, nxënësit (vetëm, në çift ose në grupe të vogla) bëjnë prova në tavolinë osë në mizanskenë, për fragmente të shkurtra (teksti dramatik mbahet para, sepse nuk është mësuar përmendësh).<br>-Diskutojnë, japin ide rreth interpretimeve të shokëve për ta përmirësuar interpretimin artistik.</td></tr>
<tr><td colspan="2">III. Vlerësimet do të bëhen mbi bazën e demonstrimeve:<br>- nën drejtimin e grupit të regjisorëve interpreton artististikisht (vetëm, në çift ose në grup), fragmente nga shfaqja teatrore që do të vihet në skenë, dukje sjellë kuptimin e qartë të saj;<br>- interpreton idetë e veta, duke komunikuar artistikisht dhe estetikisht mbi veprën teatrore;<br>- ndan përvojat e veta interpretuese dhe realizuese me të tjerë;<br>- reflekton emocionet që i krijon një vepër skenike gjatë kohës që interpretohet;<br>- vlerëson rëndësinë e punës individuale dhe të bashkëpunimit në grup.</td></tr>
<tr><td colspan="2">IV. Detyrat dhe puna e pavarur:<br>Veprimtari dhe punë kërkimore individuale ose në grup<br>- Nxënësit do të punojnë për ta përvetësuar më mirë rolin dhe për të fituar shkathtësi në interpretimin artistik të shfaqjes teatrore të projektit.<br>-Sillni nga mediat imitime, etyde, interpretime aktorësh të spektakleve televizive (p.sh: nga spektakli “Portokalli” i Top Chanel).<br>Punimet ruhen në dosjen personale dhe janë pjesë e punëve për vlerësim të përgjithshëm.</td></tr>
</table>

**Data**________________

**PLANIFIKIMI DITOR 20**

| **Fusha: Gjuhët dhe komunikimi teatror** | **Lënda: Arte** | **Shkalla: V** | **Klasa: X** |
|---|---|---|---|

| | |
|---|---|
